



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 48 regjistër (JR)
Datë 19.11.2024

Nr. 96 i vendimit
Datë 17.12.2025

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 17.12.2025, ditën e mërkurë, ora 11:30 në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 48/2024 (JR), datë 19.11.2024, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Sabri Kastrati, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 800, datë 19.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Sabri Kastrati.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; si dhe “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e

ankimit të subjektit të rivlerësimit Sabri Kastrati, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 800, datë 19.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Sabri Kastrati (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar se: *a) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin; b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive; c) ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite; d) ka kryer deklarim të rremë; e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Sabri Kastrati.
5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Sabri Kastrati, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 800, datë 19.09.2024, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Sabri Kastrati, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë [...].*
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, mbështetur në konkluzionet për secilin prej kritereve të rivlerësimit, si vijojnë.
 - Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: *Komisioni ka arritur në përfundimin se: (i) Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë vetting, sipas parashikimit të shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. (ii) Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas parashikimit të shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.*
 - Për kriterin e kontrollit të figurës: *Subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar me vërtetësi deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, në kundërshtim me parashikimet e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
 - Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se, pavarësisht problematikave të konstatuara, për një vlerësim tërësor të këtij kriteri, subjekti ka arritur nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.*
 - Bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, mbi të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioni arriti në konkluzionin se: *Subjekti i rivlerësimit nuk arriti t’i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me kriterin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe disa problematika të konstatuara te kriteri i aftësive profesionale, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia, sipas përcaktimit të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti nuk provoi bindshëm: i) Burimet e ligjshme financiare për krijimin e pasurive në pronësi të tij, duke u gjendur në parashikimet e pikave 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. ii) Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me kontrollin e figurës, në kundërshtim me sa parashikohet në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përputhje nenin 61/3 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

9. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit me ankim kundër vendimit nr. 800, datë 19.09.2024, duke e kundërshtuar atë si një vendim të pabazuar në fakte dhe në ligj, dhe rezultat i zbatimit të gabuar të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
10. Bazuar në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, nenin F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të

Kushtetutës, nenet 59 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë: *Ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Sabri Kastrati, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.* Subjekti i rivlerësimit nuk i ka bashkëlidhur ankimit të tij prova të reja.

IV. Shqyrtimi i ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin kalimtar të subjektit Sabri Kastrati, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

12. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 800, datë 19.09.2024, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
14. Trupi gjykues, pasi kontrollon zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni

15. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi i Komisionit është marrë në shkelje të disa parimeve të procesit të rregullt ligjor, për shkak se: (i) Komisioni nuk përmbush kriteret e një gjykate të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me parashikimet në nenin 6 të KEDNj-së. (ii) Vendimi i Komisionit është rezultat i zbatimit të gabuar të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. (iii) Konkluzioni i Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, është i pambështetur, i paargumentuar dhe i marrë në kundërshtim me provat e administruara në gjykim dhe analizimit të tyre. Procesi ka qenë i paragjykuar dhe vendimi është marrë bazuar në fakte të pavërteta dhe që nuk i përgjigjen realitetit dhe provave të paraqitura, sipas të cilave provohen bindshëm dhe pa asnjë mëdyshje fakte që janë mohuar apo keqinterpretuar nga Komisioni. (iv) Procesi i zhvilluar ndaj tij, nuk është bazuar në parimet e përgjithshme të legjislacionit shqiptar, të objektivitetit, paanësisë, proporcionalitetit, efektivitetit dhe respektimit të të drejtave të palëve në proces për njoftimin në kohën e duhur mbi ecurinë e procesit dhe dhënien e kohës së mjaftueshme për mbrojtje efektive, në respektim të frymës së legjislacionit të brendshëm, si dhe konventave ndërkombëtare, të cilat janë pjesë e sistemit juridik dhe kanë përparësi në hierarkinë e normave. (v) Kontrolli i figurës është kryer në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore. (vi) E gjithë procedura e ndjekur dhe vendimmarrja e Komisionit kanë elemente të theksuara të paragjykimit dhe të një vendimi të paracaktuar. (vii) Kufizimet e të drejtave të subjekteve nuk mund të tejkalojnë kufizimet e vendosura nga KEDNj-ja dhe duhet të jenë në përputhje me garancitë kushtetuese të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, të cilat nuk mund të zhbëhen nga neni A i Aneksit të Kushtetutës. (viii) Vendimi është i paarsyetuar.
16. Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk përmbush kriteret e një gjykate të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me parashikimet e nenit 6 të KEDNj-së, për shkak se e njëjta trupë gjykuese ka bërë hetimin administrativ, si dhe ka marrë vendimin përfundimtar, trupi gjykues thekson se, në lidhje me këtë çështje, është krijuar jurisprudencë e konsoliduar, sipas së cilës këto pretendime janë vlerësuar të pabazuara në ligj, qëndrim të cilin Kolegji e ka bazuar në faktin se veprimtaria e trupës gjykuese të Komisionit, kompetencat në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017. Trupi gjykues vëren se në të njëjtin konkluzion për moscenim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, ka arritur edhe GjEDNj-ja në çështjen gjyqësore *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*¹, në drejtim të vlerësimit të pretendimeve të ngjashme të kërkuases lidhur me cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.
17. Në lidhje me pretendimin e subjektit se vendimi është i pambështetur, i paargumentuar dhe i marrë në kundërshtim me provat e administruara në gjykim, dhe është rezultat i hamendësimeve dhe paragjyqimeve që kanë shoqëruar procesin e tij, bazuar në fakte të pavërteta dhe që nuk i përgjigjen realitetit dhe provave të paraqitura, trupi gjykues vlerëson se

¹ *Shih paragrafët 307, 308 dhe 317 të të njëjtit vendim të GjEDNj-së.*

fakti që Komisioni nuk ka pranuar në vendimin e tij pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nuk dëshmon domosdoshmërisht mungesë të analizës dhe vlerësimit të provave, apo të arsyetimit të vendimit. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se këto pretendime gjenden të pambështetura.

18. Sa i takon pretendimit të subjektit se në procesin e zhvilluar ndaj tij, Komisioni nuk ka zbatuar parimet e përgjithshme të objektivitetit, paanësisë, proporcionalitetit, efektivitetit dhe respektimit të të drejtave të palëve në proces për njoftimin në kohën e duhur mbi ecurinë e procesit dhe krijimit të garancive për mbrojtje efektive, në përputhje me frymën e legjislacionit të brendshëm, si dhe konventave ndërkombëtare, trupi gjykues thekson se procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e një sërë parimesh themelore kushtetuese, përfshirë barazinë përpara ligjit, ligjshmërinë, proporcionalitetin, objektivitetin, kontradiktoritetin, të drejtën për t'u dëgjuar dhe paraqitur prova, si dhe parime të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në kushtet kur vendimi i Komisionit i nënshtrohet kontrollit nga ana e Kolegjit, si për aspekte të natyrës procedurale, si dhe themelit të çështjes, trupi gjykues vlerëson se respektimi i parimeve të procesit të rregullt ligjor garantohet nëpërmjet këtij kontrolli.
19. Në vlerësim të pretendimit të subjektit se procedura e ndjekur nga Komisioni për kontrollin e figurës, përbën shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor, pasi Komisioni ka verifikuar edhe mënyrën e fitimit nga ana e tij të shtetësisë australiane, edhe pse ky element nuk përbën objektin e kontrollit sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, referuar përmbajtjes së rezultateve të hetimit, trupi gjykues konstaton se pyetjet e drejtuara subjektit të rivlerësimit dhe barra e provës, nëpërmjet të cilave është kërkuar që subjekti të sqarojë mënyrën e fitimit të shtetësisë australiane, lidhen me verifikimin e elementeve të rëndësishme të analizës mbi saktësinë dhe vërtetësinë e plotësisë të deklaratës për kontrollin e figurës nga subjekti i rivlerësimit. Në këtë këndvështrim, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se procesi hetimor i kryer nga Komisioni, është në tejkalim të ligjit dhe ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, vlerësohet i pambështetur.
20. Lidhur me pretendimin e subjektit se vendimi i Komisioni, përveçse i paragjykuar dhe i paracaktuar, nuk përmbush standardin minimal të arsyetimit, pasi mbart mungesë thelbësore të fakteve, shtrembërim të tyre apo edhe zbatim të gabuar të ligjit në formën e abstragimit faktik e ligjor, argumenteve alogjike apo edhe të sajimit të rregullave që nuk ekzistojnë, duke shkelur në këtë mënyrë një element të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, trupi gjykues vlerëson se, në një vështrim të përgjithshëm të përmbajtjes së vendimit, ai paraqitet i plotë në elementet formale dhe plotëson të gjitha kërkesat e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me arsyetimin e vendimit, duket se kanë të bëjnë me vlerësimin prej Komisionit të provave apo shpjegimeve të subjektit në mënyrë të ndryshme nga pritshmëritë e tij, situatë e cila nuk çon domosdoshmërisht në konkluzionin se vendimi është i paarsyetuar, duke e bërë në këtë mënyrë pretendimin e subjektit të pabazuar.
21. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka cenuar të drejtën e tij për një jetë private, parashikuar në nenin 8, paragrafi 2 i KEDNj-së, pasi ky vendim jo vetëm ka pakësuar të ardhurat e subjektit, por ka cenuar rëndë reputacionin e tij profesional, si dhe ka sjellë pasojën e përjashtimit të tij nga sistemi i drejtësisë, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim është i pambështetur.

22. Sikurse elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, por tashmë konfirmuar edhe nga kontrolli i kryer nga GjEDNj-ja nëpërmjet çështjes kyç të rivlerësimit, *Xhoxhaj k. Shqipërisë*, masa disiplinore e shkarkimit, parashikuar nga ligji shqiptar, nuk është disproporcionale dhe as në shkelje të parimeve të nenit 8 të Konventës². Procesi i rivlerësimit nuk passjell ndalimin e ushtrimit të profesionit në çdo kapacitet për magjistratët që nuk arrijnë ta kalojnë me sukses atë. Po ashtu, sikurse është elaboruar nga GjEDNj-ja në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*³, është i pabazuar pretendimi për cenim të jetës private, bazuar në frikën për të ardhmen për ushtrimin e profesionit, pa pasur një akt konkret që e pengon në ushtrimin e kësaj të drejte.

23. Në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, GjEDNj-ja ka vlerësuar se shkarkimi nga detyra i subjekteve për shkak të shkeljeve të konstatuara, nuk është inkonsistent apo disproporcional me qëllimin që kërkohet të arrihet nga shteti, pasi ka konsideruar se kontrolli i pasurive nuk përfshin një aspekt intim të sjelljes private.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

➤ *Në lidhje me pasurinë apartament, me sipërfaqe 76 m², i ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë:*

24. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se: *nuk u provuan nga subjekti, të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

25. Në këtë konkluzion, Komisioni ka arritur pasi ka analizuar burimet e krijimit të kësaj pasurie, duke konstatuar se:

25.1. Subjekti i rivlerësimit nuk dokumentoi të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 2006, si dhe nuk provoi pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e pasurisë, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

25.2. Sa i takon shumës 30.000 euro, marrë hua nga shtetasi Y. E., Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të ardhurat e ligjshme të huadhënësit për shumën 30.000 euro, e përdorur si burim për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi, dhe se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk ka detyrim për të provuar ligjshmërinë e tyre, pasi huaja e marrë nga vëllai, është përdorur nga subjekti si burim për krijimin e pasurisë apartament dhe, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti kishte detyrimin për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Përfundimisht, subjekti nuk provoi të ardhurat e ligjshme të huadhënësit për shumën 30.000 euro, e përdorur si burim për krijimin e pasurisë apartament.

25.3. Lidhur me kursimet në shumën 7.000 euro, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë masën e të ardhurave të realizuara nga punësimi i tij në emigracion. Komisioni ka

² *Shih paragrafët 402 dhe 403 të vendimit të GjEDNj-së në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë.*

³ *Në paragrafin 66: “[...] Frika se ajo mund të bëhet viktimë e një shkeljeje të Konventës, duke u përjashtuar në të ardhmen nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, nuk është e mjaftueshme që subjekti të pretendojë se rrezikon të prekej drejtpërdrejt nga neni 13(2) i Ligjit për Avokatët dhe se, në këtë mënyrë, ishte viktimë e shkeljes së të drejtave të saj të Konventës në këtë drejtim”.*

vlerësuar po ashtu se mungesa e deklarimit të këtyre kursimeve *cash*, passjell pamundësinë për t'i përlloritur ato si të ardhura për vitin pasardhës. Përfundimisht, Komisioni ka vlerësuar se, edhe në rast se do të konsiderohej pamundësia e subjektit për të siguruar dokumentacionin e plotë në lidhje me këto të ardhura, ky fakt nuk do të ishte me peshë në vlerësimin përfundimtar, porë kjo së bashku me problematikat e tjera për kriterin e pasurisë.

26. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, duke pretenduar se të ardhurat e deklaruarat si burim për krijimin e saj, janë të ligjshme dhe konkluzioni i arritur nga Komisioni është në kundërshtim me faktet dhe provat e paraqitura, ligjin dhe jurisprudencën e Kolegjit. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti ka ngritur një sërë pretendimesh në drejtim të burimeve financiare që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë, si më poshtë.

26.1. Në lidhje me shumën 48.000 euro, dhënë nga vëllai i tij M.⁴ K., subjekti pretendoi se, pavarësisht se ka mungesë dokumentacioni mbi pagesat e detyrimeve tatimore e të ardhurave të përfituara nga qiradhënia në shumën 48.000 euro, kjo marrëdhënie nuk ka qenë marrëdhënie e mirëfilltë qiraje, dhe se vëllai i tij M. K. ia ka dhënë për blerje shtëpie këtë shumë, për shkak të përdorimit pa shpërblim të pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit në objektin “{***}”, në Kukës, i cili iu është lënë trashëgim nga babai. Subjekti ka sqaruar se ndarja e pjesëve takuese në lidhje me këtë objekt, nuk është formalizuar për shkak të marrëdhënies familjare, megjithatë, duke qenë se ai ishte pa shtëpi dhe sapo ishte kthyer nga emigrimi, vëllai i madh ka menduar që t'i kthejë mbrapsht kontributin e mëparshëm ndaj familjes, dhe i ka dhënë shumën 48.000 euro si një lloj kompensimi për përdorimin pa shpërblim të pjesës së tij takuese të pasurisë së lënë trashëgim nga i ati, duke mundësuar edhe blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi.

26.2. Në lidhje me huanë 30.000 euro, marrë hua nga vëllai i tij shtetasit Y. E., subjekti pretendoi se Komisioni nuk e ka konsideruar si të ligjshme këtë shumë, megjithëse ka pranuar se shoqëria “{***}” ShPK, në vitet e marra në analizë, ka pasur fitim më të madh se sa shuma e dhënë hua. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet e tij dhe vlerësimi në lidhje me këtë pasuri, është në kundërshtim me praktikën e Kolegjit⁵ dhe shkel parimin e barazisë para ligjit dhe parimin e arsyetimit të vendimit.

26.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi edhe konkluzionin e Komisionit lidhur me të ardhurat nga emigracioni në shumën 7.000 euro, duke pretenduar se shprehja e Komisionit se: *[...] edhe po të merreshin si të ligjshme këto të ardhura, nuk do të ndikonin në vendimmarrjen e tij*, tregon se vendimmarrja ka qenë e paragjykuar, e paracaktuar dhe se Komisioni nuk ka treguar seriozitetin e duhur në trajtimin e prapësimeve të tij, si dhe nuk ka zbatuar parimin e arsyetimit të vendimit. Sipas subjektit, Komisioni nuk ka marrë parasysh se ai ka qenë në kushtet e pamundësisë objektive për të paraqitur dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e realizuara prej tij në emigracion para fillimit të detyrës, si dhe se Komisioni në vendimmarrjen e tij, ka aplikuar standarde të ndryshme për raste të ngjashme⁶, duke shkelur haptazi parimin e barazisë para ligjit, pasi vetë Komisioni, në raste të tjera ku janë trajtuar të

⁴ Ky person shfaqet në vendimin e Komisionit, si dhe nëpër dokumente, me emër: M., M. dhe M. K. Për efekt të unifikimit, në këtë vendim do të përdoret emri i tij sipas dokumentit të identifikimit të gjendur në fashikullin e Komisionit, M. K.

⁵ Subjekti i referohet vendimit nr. 14, datë 16.05.2022, të Kolegjit.

⁶ Subjekti i referohet vendimit nr. 81, datë 26.11.2018, të Komisionit, i formës së prerë.

ardhurat e krijuara nga subjektet e rivlerësimit para fillimit të detyrës, ka mbajtur qëndrim se mungesa e dokumentacionit justifikues për pasuritë e krijuara, nuk përbën shkak për penalizimin e subjektit. Vendimmarrja e Komisionit është në kundërshtim flagrant edhe me jurisprudencën e GjEDNj-së⁷.

27. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin gjyqësor të çështjes dhe arsyetimin e Komisionit në vendim, trupi gjykues konstatoi si vijon.
28. Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sipërfaqe 76,07 m², me vendndodhje rr. “{***}”, Tiranë, shk. {***}, kati i parë, apartamenti nr. {***}, numër pasurie {***}, sipas kontratës së porosisë {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.02.2006⁸. Burimi i krijimit të kësaj pasurie, është nga të ardhurat e qirasë së pasurisë së paluajtshme “{***}”, me adresë lagjia nr. {***}, Kukës, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.02.2006. Pasuri e cila është trashëgimi nga babai, e ndërtuar para kohës kur kam filluar punën si prokuror, e deklaruar që në momentin e fillimit të punës. (Kjo pasuri është deklaruar prej meje në deklarimet e mëparshme pasi aktualisht ajo nuk ndodhet më në pronësinë time, sepse kam bërë një kontratë shkëmbimi për të cilën do të jap shpjegime në vijim).*
29. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri për herë të parë në DIPP-2006: *Blerje apartamenti, k. porosie nr. {***}, datë 22.02.2006, me sip. 84 m², adresa: rr. “{***}”, Tiranë. Shuma e blerjes e likuiduar. Vlera e deklaruar: 55.000 euro, me pjesë takuese 50%, si dhe ka deklaruar: Të ardhura nga dhënia me qira e pjesës sime takuese të bar-restorant “{***}”, për një periudhë 5-vjeçare, qiraja është parapaguar nga qiramarrësi M. K. dhe restoranti është dhënë me qira në shkurt të vitit 2002, me 800 euro/muaji. Vlera e deklaruar është 48.000 euro.*
30. Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2005, subjekti ka deklaruar: *Supermarket, restorant, hotel, garazh (objekt 5-katësh), i ndodhur në Kukës, i quajtur Kompleksi {***}, është në pronësinë time dhe të dy vëllezërve M. dhe V. K., me pjesë takuese 33% dhe vit krijimi 1998.*
31. Sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.02.2006, të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij M. K., subjekti deklaroi se: *Në bazë të dëshmisë së trashëgimisë, është pronar në pasurinë me emërtimin “{***}”, me adresë: L. {***}, Kukës, me sip. 450 m², kati i 2-të. Këtë lokal, unë ia jap me qira z. M. K. për një periudhë 5-vjeçare, qira e cila ka filluar që në datën e sotme. Kuota e qirasë mujore që i paguan qiramarrësi, z.*

⁷ Subjekti i referohet vendimit të GjEDNj-së në çështjen Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë, ku është arsyetuar se: “Gjykata vëren se është i rëndësishëm fakti se ajo nuk ishte bërë ende prokurore apo zyrtare publike e një roli tjetër që t’u nënshtruhej ligjeve për deklarimin e pasurisë”.

⁸ Sipas kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.2.2006, me shoqërinë sipërmarrëse “{***}” ShPK, për ndërtimin e një apartamenti (2+1) me sipërfaqe 84,19 m², të ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, kundrejt çmimit 55.000 euro, i likuiduar plotësisht. Në vijim, midis subjektit dhe shoqërisë ndërtuese është nënshkruar kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.4.2013, për blerjen e apartamentit me nr. pasurie {***}, me sipërfaqe 76,07 m², në vlerën 55.000 euro, e cila deklarohet se është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale. Apartamenti figuron i regjistruar në pronësi të subjektit, sipas certifikatës së pronësisë në datën 7.5.2013.

M. K., z. Sabri Kastrati është 800 (tetëqind) euro. Likuidimi i kësaj shume është bërë në dorë, paradhënie për të gjithë periudhën 5-vjeçare të qirasë.

32. Lidhur me të ardhurat nga qiraja, gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se: *Pasi jam kthyer nga Australia dhe rifilluar detyrën e prokurorit, administrimin e pjesës sime takuese në pasurinë e paluajtshme me emërtimin “{***}”, ia kam lënë vëllait tim të quajtur M. K.. Nëpërmjet një marrëveshjeje midis vëllezërve, kemi rënë dakord se, duke qenë se mua më duhej të siguroja një banesë në qytetin e Tiranës, për administrimin e pjesës sime takuese, vëllai im të më jepte si parapagim shumën prej 48.000 eurosh. Duke pasur parasysh marrëdhënien e posaçme midis vëllezërve, faktin që prej vitit 1993 deri në vitin 2005, të gjitha të ardhurat e fituara prej meje janë dorëzuar në ekonominë e përbashkët familjare, faktin se tashmë vëllai im M. K. ishte në rolin e kryefamiljarit (pas vdekjes së babait tonë) dhe për shkak të këtij roli ndjente detyrimin e tij për të më ndihmuar në sigurimin e një banese, dhënia e kësaj vlere nuk është parë prej meje në këndvështrimin e një kontratë qiraje sipas përcaktimeve të Kodit Civil dhe prandaj, për këtë shumë, nuk kam paguar tatim mbi qiranë.*
33. Nisur nga shpjegimet e subjektit, se shuma 48.000 euro nuk është e ardhur që ka buruar nga një marrëdhënie e mirëfilltë qiraje, sipas përcaktimeve të Kodit Civil, Komisioni i ka kërkuar atij⁹ të depozitojë dokumentacion justifikues mbi të ardhurat e ligjshme të vëllait M. K. për dhënien e shumës 48.000 euro. Në përgjigje¹⁰, subjekti ka shpjeguar se kjo shumë i është dhënë nga vëllai i tij për blerjen e shtëpisë, për shkak të përdorimit pa shpërblim të pjesës së tij takuese (“{***}”) dhe se një pjesë të kësaj shume, vëllai i tij ia kishte marrë hua shtetasit Y. E., fakt për të cilin ka ardhur në dijeni pas plotësimit të deklaratës *vetting* dhe pasi ka dhënë shpjegimet përkatëse në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së më datë 28.01.2016¹¹.
34. Në lidhje me të ardhurat e z. Y. E., subjekti ka paraqitur si provë kopje të bilanceve të viteve 2004, 2005 dhe 2006 të shoqërisë “{***}” ShPK, në pronësi të shtetasit Y. E., të cilat, sipas tij, provojnë se huadhënësi i vëllait të tij ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huasë. Gjithashtu, subjekti ka depozituar edhe një deklaratë noteriale¹² (për njohje dhe likuidim të borxhit pa interes) të datës 26.01.2017, të nënshkruar nga M. K. dhe Y. E., ku ky i fundit deklaroi se në datën 13.01.2006, i ka dhënë M. K. shumën prej 30.000 eurosh, pa interes, shumë të cilën e ka likuiduar me këste brenda datës 31.12.2008.
35. Nga verifikimi i ekstraktit historik të QKB-së, Komisioni ka konstatuar se shoqëria “{***}” ShPK (me NUIS {***}), është regjistruar më datë 01.07.1996, në Kukës, me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin Y. E., zotërues 100%¹³. Referuar dokumentacionit të administruar në

⁹ Nëpërmjet pyetësorit të datës 20.10.2023.

¹⁰ Në përgjigjet e dhëna te pyetësori i depozituar në datën 30.10.2023.

¹¹ Në shpjegimet e tij pranë ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar se, nga biseda me vëllain, ai i ka bërë me dije se një pjesë të shumës 30.000 euro, ai e kishte marrë borxh te djali i tezes Y. E., i cili merret me aktivitet ndërtim rrugësh, shoqëria “{***}” ShPK në Kukës, dhe këtë shumë ia ka shlyer me kalimin e viteve.

¹² Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.01.2017, e përpiluar nga noteri B. G.J., vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga vetë noteri me shkresën nr. prot. {***}, datë 15.02.2024.

¹³ Referuar ekstraktit historik të QKB-së për shoqërinë “{***}” ShPK (me NUIS {***}), rezulton se kjo shoqëri është themeluar në datën 20.5.1995 dhe është regjistruar në datën 1.7.1996 në Kukës, me status “aktiv”, me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin Y. E. (zotërues i 100% të kuotave).

Komision, Drejtoria Rajonale Tatimore (në vijim “DRT”) Kukës¹⁴ ka dërguar bilancet e kësaj shoqërie për vitet 2000, 2003 – 2007, si dhe ka informuar se kjo shoqëri nuk ka shpërndarë dividend për asnjë nga bilancet e mësipërme. Nisur nga ky fakt, Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitohet dokumentacioni justifikues mbi të ardhurat e ligjshme të shtetasit Y. E. për dhënien e huasë, ku të provohet pagesa e tatimit në kuptim të ligjit.

36. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion tjetër justifikues, duke u mjaftuar me shpjegimin e bilancet e shoqërisë “{***}” ShPK, për vitet 2004 – 2005, të depozituara më herët prej tij, janë të mjaftueshme për të provuar të ardhurat e shtetasit Y. E., dhe deklarata noteriale të lëshuar prej këtij të fundit provon dhënien e huasë. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se, pavarësisht faktit se shoqëria “{***}” ShPK nuk ka shpërndarë dividend në vitet në fjalë, kjo nuk nënkupton se huadhënësi nuk ka pasur mundësi financiare për t’i dhënë huanë në shumën prej 30.000 eurosh vëllait të tij M. K.
37. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se, sipas dokumentacionit të administruar për shoqërinë “{***}” ShPK, subjekti nuk ka dokumentuar të ardhurat e ligjshme të shtetasit Y. E. për shumën 30.000 euro, në kuptim të ligjit, për rrjedhojë analiza financiare mbi mundësitë e këtij të fundit për dhënien e huasë 30.000 euro në vitin 2006, do të rezultonte me balancë negative për të gjithë shumën.
38. Në lidhje me burimin prej 18.000 eurosh, si e ardhur e vëllait M. K., gjatë hetimit në Komision, subjekti ka shpjeguar se vëllai i tij ka pasur aktivitet privat, si administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe ka depozituar si dokumentacion provues ekstrakt të llogarisë bankare të shoqërisë, pranë Raiffeisen Bank, për periudhën 2004 – 2008. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti ka paraqitur dokumentacion të shoqërisë “{***}” ShPK, të tillë si: kontrata të furnizimit me mallra dhe shërbime të lidhura me ente të ndryshme shtetërore e private, si dhe akte bankare¹⁵ të kësaj shoqërie për periudhën 2009 – 2016.
39. Nga verifikimi i ekstraktit historik të QKB-së për shoqërinë “{***}” ShPK (me NUIS {***}), ka rezultuar se kjo shoqëri është regjistruar në datën 07.04.2003, me seli në lagjen nr. {***}, Kukës, me ortak të vetëm shtetasin M. K. (zotërues i 100% të kuotave), ku objekti i veprimtarisë është shumë i gjerë. Gjatë periudhës 2001 – 2008, shtetasi M. K. ka qenë administrator i kësaj shoqërie. DRT Kukës, nëpërmjet shkresës kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 09.04.2024, ka bashkëlidhur bilancet e shoqërisë “{***}” ShPK, sipas të cilave, për vitin 2003, referohet humbje nga aktiviteti në shumën 492.288 lekë; për vitin 2004, referohet humbje nga aktiviteti në shumën 345.431 lekë dhe, për vitin 2005, referohet fitim nga aktiviteti në shumën 126.345 lekë. Po ashtu, në këtë shkresë, DRT Kukës ka bërë me dije se kjo shoqëri nuk ka shpërndarë dividend për asnjë nga bilancet e mësipërme.
40. Nga hetimi administrativ, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion justifikues të ardhurat e ligjshme të vëllait të tij në kuptim të ligjit, për rrjedhojë analiza mbi

¹⁴ Me shkresën nr. {***} prot., datë 9.4.2024.

¹⁵ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti: i) nxjerrje llogarie të lëshuar nga Raiffeisen Bank në datën 7.3.2007, të shoqërisë “{***}”, për periudhën 2006 – 2007; ii) nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank në datën 14.1.2016, për periudhën 5.1.2009 – 14.1.2016; iii) nxjerrje llogarie të Alpha Bank, datë 14.1.2016, për periudhën 2.7.2010 – 14.1.2016; iv) nxjerrje llogarie të Credins Bank, datë 14.1.2016, për periudhën 20.6.2014 – 31.12.2015.

mundësinë financiare të këtij të fundit do të rezultonte me balancë negative për të gjithë shumën 18.000 euro.

41. *Në lidhje me burimin në shumën prej 7.000 eurosh*, pretenduar si e ardhur nga emigracioni, në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit shumën 48.000 euro, por nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për diferencën e çmimit të paguar në shumën prej 7.000 eurosh (total vlera e pasurisë në shumën 55.000 euro). Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2005, si dhe në DIPP-2006 (vit i blerjes së apartamentit), subjekti nuk ka deklaruar të ardhura të realizuara nga emigracioni, kursime *cash* apo likuiditete në bankë.
42. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka shpjeguar se shuma 7.000 euro ka si burim kursimet e tij të realizuara me të ardhura nga punësimi në Australi, nga viti 1999 deri në vitin 2001. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka depozituar si provë dokumentin e datës 11.01.2001 “Fondi i Pensioneve - Apartamentet {***}”, lëshuar nga Konsulenca {***} (i përkthyer nga gjuha angleze), drejtuar subjektit, ku referohet se, sipas njoftimit të punëdhënësit, anëtarësia e tij në fondin e pensioneve ka përfunduar, me një përfitim total në shumën prej 2.641 AUD.
43. Subjekti pretendoi se e ka të pamundur të gjejë dokumentacion justifikues për pagimin e taksave në lidhje me të ardhurat e tij nga punësimi në Australi, pasi detyrimi për ruajtjen e këtij dokumentacioni ka një afat të caktuar ligjor dhe maksimumi i kohës për të cilën kompanitë janë të detyruara të ruajnë të dhënat, është 7 vjet¹⁶. Subjekti pretendoi se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe se mosparaqitja e këtij dokumentacioni është për shkak të arsyeshme¹⁷.
44. Lidhur me mosdeklarimin e këtyre të ardhurave, subjekti ka sqaruar se kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së eksperiencës, pasi ishte hera e parë që bënte një deklaram të tillë.
45. Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e ligjshme për krijimin e kursimeve në shumën 7.000 euro dhe, për pasojë, kjo shumë u konsiderua me mungesë burimesh.
46. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje me konstatimet se: (i) *Subjekti i rivlerësimi ka mungesë dokumentacioni mbi pagesat e detyrimeve tatimore për shumën 48.000 euro si e ardhur nga qiradhënia e pasurisë në bashkëpronësi “{***}”, deklaruar si burim për blerjen e apartamentit.* (ii) *Nuk u provuan të ardhurat e ligjshme të vëllait për shumën 48.000 euro, dhënë subjektit.* (iii) *Në DIPP-2005, subjekti nuk ka deklaruar kursime nga puna në emigracion.* (iv) *Ka mungesë dokumentacioni për të ardhurat e përfituara nga emigracioni në vite, në shumën 7.000 euro.* (v) *Analiza mbi mundësitë e subjektit për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë, në vitin 2006, ka rezultuar me një balancë negative në shumën (-) 6.832.166 lekë.*

¹⁶ Për verifikimin e këtij fakti, subjekti i rivlerësimi ka paraqitur në Komision link-un: <https://www/record-www-to-keep-www-for>.

¹⁷ Subjekti ka bashkëlidhur postën elektronike të datës 26.10.2023, në adresën elektronike: {***}, dhe pretendon se nuk ka marrë përgjigje në lidhje me të dhënat e punësimit të tij.

47. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vëren se konkluzionin në lidhje me këtë pasuri, Komisioni e ka bazuar në konstatimet se subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk dokumentoi të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 2006, si dhe nuk provoi pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e pasurisë, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
48. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, në DIPP- 2006, si dhe në deklaratën e përbashkët noteriale me vëllain e tij M. K. në vitin 2006, trupi gjykues konstaton se shuma prej 48.000 eurosh është deklaruar si e ardhur nga qiraja dhe, për efekt të parashikimit në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të provonte se për këto të ardhura të përfituara janë paguar detyrimet tatimore.
49. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka pranuar se, në lidhje me këto të ardhura të deklaruara prej tij si në deklaratën *vetting*, ashtu edhe në DIPP- 2006, nuk ka shlyer detyrimet përkatëse, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit *nuk provoi pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e pasurisë, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës* e, për pasojë, ato nuk mund të llogariten si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë apartament në Tiranë.
50. Gjatë procesit në Komision, subjekti ka ndryshuar qëndrim në lidhje me burimin e shumës 48.000 euro, duke pretenduar përfundimisht se në fakt ato nuk burojnë nga një marrëdhënie e mirëfilltë qiraje, por se vëllai i tij ia ka dhënë në formën e një kompensimi për gjithë kontributin e dhënë ndaj familjes, si një lloj shpërblimi për përdorimin pa pagesë të pjesës së tij takuese të pasurisë së lënë trashëgim nga babai i tyre, si dhe për ta ndihmuar atë për blerjen e një apartamenti.
51. Nisur nga këto deklarime¹⁸, Komisioni e ka zgjeruar hetimin duke marrë në shqyrtim edhe burimin e të ardhurave të vëllait të tij për dhënien e kësaj shume, duke analizuar ligjshmërinë e të ardhurave me vlerë 30.000 euro, të pretenduara si hua nga shtetasi Y. E. te vëllai i tij M. K., si dhe të ardhurat në shumën 18.000 euro të këtij të fundit.
52. Në lidhje në shumën 30.000 euro, hua e marrë nga vëllai i subjektit shtetasit Y. E., trupi gjykues vëren se, referuar bilanceve të shoqërisë “{***}” ShPK, ku administrator dhe ortak i vetëm është shtetasi Y. E., rezulton se kjo shoqëri nuk ka shpërndarë dividend për periudhën 2004 – 2006. Pavarësisht se bilancet e paraqitura në cilësinë e provës nga ana e subjektit të rivlerësimit, dëshmojnë aktivitet fitimprurës për shoqërinë “{***}” ShPK, aktet e paraqitura nga subjekti nuk provojnë përfitimin e këtyre të ardhurave nga Y. E. në kuptim të ligjit, për sa kohë nuk rezulton dokumentacion provues i tillë, si: mandate apo akte bankare, që provojnë se shtetasi Y. E., në cilësinë e ortakut të kësaj shoqërie, i ka përfutuar këto likuiditete nga shoqëria e tij
53. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë depozituar dokumentacion justifikues për të provuar të ardhura të tjera të shtetasit Y. E., duke u mjaftuar me argumentin se bilancet e shoqërisë “{****}” ShPK, për vitet 2004 – 2005, të depozituara më herët prej tij, janë të mjaftueshme për të provuar se shtetasi Y. E. ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për

¹⁸ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 30.10.2023, si dhe shpjegimet e subjektit në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 28.01.2016.

dhënien e huasë vëllait të tij. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka provuar të ardhurat e ligjshme të shtetasit Y. E. për dhënien e huasë prej 30.000 eurosh vëllait të subjektit.

54. Në lidhje me shumën prej 18.000 eurosh, si e ardhur e vëllait M. K., trupi gjykues vëren se, gjatë hetimit administrativ, Komisioni¹⁹ ka analizuar të ardhurat e vëllait të subjektit M. K. për krijimin e kësaj shume, dhënë subjektit në vitin 2006 (si pjesë e shumës 48.000 euro), duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat e vëllait në kuptim të ligjit e, për rrjedhojë, analiza financiare e tij do të rezultonte negative për të gjithë shumën. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar të ardhurat e ligjshme të vëllait për të gjithë shumën 48.000 euro.
55. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, ka dhënë sqarime vetëm sa i takon huasë në shumën 30.000 euro, marrë hua nga vëllai i tij shtetasit Y. E. dhe kursimeve të tij në shumën 7.000 euro, por nuk ka prapësuar apo sqaruar në lidhje me vlerësimit e Komisionit mbi të ardhurat e vëllait të tij në shumën 18.000 euro.
56. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ në lidhje me të ardhurat e vëllait M. K., konstatohet se, pavarësisht se shoqëria “{***}” ShPK ka përfituar/qarkulluar të ardhura nga aktiviteti tregtar, bilancet e kësaj shoqërie referojnë se fitimi i realizuar për periudhën 2004 - shkurt 2006, ka qenë në shumën 126.345 lekë në vitin 2005, të cilat janë të pamjaftueshme për krijimin e shumës 18.000 euro.
57. Sa më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur pretendime mbi analizën që Komisioni ka bërë për shumën 18.000 euro, si të ardhura të vëllait të tij, madje as në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit nuk e ka kundërshtuar në mënyrë të posaçme vlerësimin e Komisionit në lidhje me këtë shumë, trupi gjykues vlerëson se analiza e kryer nga Komisioni në lidhje me të ardhurat e vëllait të subjektit M. K., në shumën 18.000 euro, duhet të merret në konsideratë në funksion të konkluzionit se subjekti ka dështuar për të provuar të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë objekt verifikimi.
58. Sa i takon pretendimit të subjektit se huaja me vlerë 30.000 euro nuk është marrë prej tij, por nga vëllai i tij M. K., i cili nuk është subjekt rivlerësimi dhe nuk ka detyrim për të provuar burimin e saj, trupi gjykues vlerëson se çështja e provueshmërisë së ligjshmërisë së burimit të krijimit të kësaj shume, në rastin në shqyrtim ka ardhur si konkluzion i analizës që Komisioni ka kryer, bazuar në deklaratimet e vetë subjektit, se të ardhurat në shumën 48.000 euro nuk janë në fakt të ardhura nga qiraja, por se ato përfaqësojnë një ndihmë/kompensim nga vëllai i tij, deklaram i cili përbën një devijim nga deklaratimet e tij në deklaratën *vetting*, në DIPP-2006, si dhe provat e paraqitura prej tij në lidhje me këto të ardhura.
59. Për më tepër, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht se subjekti ka pretenduar se të ardhurat me vlerë 48.000 euro nuk burojnë nga një marrëdhënie e mirëfilltë qiraje dhe, për këtë arsye, nuk ka paguar detyrimet tatimore, nga ana tjetër, nuk pranon se këto të ardhura janë dhurim, si dhe nuk sqaron bindshëm burimin e tyre, të cilat, në kuptim të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, përjashtohen nga tatimi.

¹⁹ Në paragrafët nr. 26.30 - 26.34 të vendimit.

60. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit sa i takon shumës 7.000 euro, të ardhura të kursyera nga puna në emigracion, deklaruar se kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament në Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues që të provojë sasinë e pretenduar të të ardhurave të përfituara prej tij gjatë periudhës që ka qenë emigrant në Australi. Po ashtu, subjekti nuk ka arritur të provojë as pretendimin e tij në lidhje me pamundësinë objektive për të gjetur dhe paraqitur dokumentacion provues lidhur me këto të ardhura.
61. Nga analizimi i akteve në fashikull, trupi gjykues konstaton se subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës printimin nga *e-mail*-i i datës 26.10.2023, dërguar shoqërisë “{***}” në Australi, megjithatë, referuar përmbajtjes së këtij *e-mail*-i, nuk është e qartë kërkesa që subjekti i ka drejtuar kësaj shoqërie dhe, për pasojë, nuk mund të konkludohet se ai ka bërë përpjekje për gjetjen dhe paraqitjen e dokumentacionit justifikues mbi punësimin dhe përfitimin e të ardhurave nga ana e tij. Përmes dokumentacionit të paraqitur me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti ka provuar vetëm të ardhurat e përfituara prej tij nga fondi i pensioneve deri në janar të vitit 2001, në shumën prej 2.641 AUD, të cilat vlerësohen të pamjaftueshme për të justifikuar shumën prej 7.000 eurosh.
62. Përveç sa më lart, referuar deklaratës para fillimit të detyrës në vitin 2005, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga punësimi në emigracion si kursime *cash*, si dhe nuk rezulton që të ketë deklaruar përdorimin e tyre si burim për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi në vitin 2006. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërlllogaritjen e këtyre të ardhurave në analizën financiare për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi.
63. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti nuk ka justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
64. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni lidhur me mundësinë e subjektit për blerjen e apartamentit në vitin 2006, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, me të njëjtin rezultat financiar si Komisioni, prej (-) 6.316.352 lekësh²⁰.
65. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se, lidhur me pasurinë e paluajtshme *apartament me sipërfaqe 76 m²*, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- *Në lidhje me pasurinë njësi me sipërfaqe 61,2 m², ndodhur në {***}, Tiranë:*
66. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor mbi të ardhurat e ligjshme të vëllait, që kanë shërbyer për blerjen e njesisë në vlerën 100.000 euro, në kundërshtim me sa*

²⁰ Pasqyruar në tabelën e përgjithshme të analizës financiare për periudhën 2005-2016, në faqen nr. 41 të vendimit të Komisionit.

parashikon neni D/3 i Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur kështu nën parashikimin e shkronjës “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

67. Komisioni, vlerësimin për këtë pasuri, e ka bazuar në konstatimet se: [...] *subjekti nuk depozitoi dokumentacion justifikues ligjor mbi të ardhurat e ligjshme të vëllait për blerjen e njësisë me vlerë 100.000 euro, pasuri e cila de jure figuron e regjistruar në pronësi të subjektit. Pretendimi i subjektit se kjo pasuri rrjedh nga një veprim juridik shkëmbimi, nuk qëndron, pasi, referuar akteve të administruara në dosje, ky veprim bazohet në një deklaram noterial midis subjektit dhe vëllait, akt i cili mund të shfuqizohet në çdo moment nga palët, e ndërsa subjekti figuron pronar i vetëm i ligjshëm i kësaj pasurie. Referuar nenit 757 të Kodit Civil, shkëmbimi është një kontratë që ka për objekt kalimin e ndërsjellë të pronësisë së sendeve ose të të drejtave të tjera nga njëri kontraktues te tjetri, ndërsa akti deklarativ noterial, e realizuar midis subjektit dhe vëllait, pavarësisht përmbajtjes së saj, nuk përmban elementet e një kontrate të mirëfilltë shkëmbimi.*
68. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e mësipërm, duke pretenduar se: (i) Komisioni ka mbajtur qëndrim në tejkallim të parashikimeve ligjore për vlerësimin e kësaj pasurie pasi marrëdhënia me vëllain e tij, ka qenë marrëdhënie shkëmbimi me kusht dhe nëse nuk përmbushet kushti, palët do të kthehen në gjendjen e mëparshme; (ii) konkluzioni i Komisionit se nuk kemi të bëjmë me një kontratë shkëmbimi, por me një deklaram noterial, e cila mund të revokohet në çdo kohë nga palët, është absurd pasi, edhe po të ishte kontratë shkëmbimi, ky veprim mund të shfuqizohej në çdo kohë me vullnetin e palëve; (iii) interpretimi i Komisionit, mbështetur në titullin e aktit dhe jo në përmbajtjen e tij, është alogjik dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 681 të Kodit Civil, i cili ka përcaktuar se: *Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës;* (iv) kjo marrëdhënie nuk është marrëdhënie dhurimi apo huaje e, për rrjedhojë, vëllai i tij nuk ka detyrimin që, bazuar në nenin 34, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të justifikojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij.
69. Trupi gjykues, pasi analizoi aktet e fashikullit të Komisionit, në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton si në vijim.
70. Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar: *Njësi me sipërfaqe 61,2 m², me vendndodhje {***}, me numër {***}, z.k {***}. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është kontrata për heqje dorë nga pronësia me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.09.2013, me anë të së cilës vëllai im, i quajtur V. K., ka hequr dorë nga pronësia mbi njësinë e sipërpërmendur, duke e kaluar në pronësinë time, në këmbim të pronës me emërtim pasuri e paluajtshme “{***}”, me adresë: lagjja nr. {***}, Kukës, pronë e cila kalon në pronësinë e V. K. pasi të përfundojë procedura e regjistrimit të kësaj prone. Deri në momentin e kryerjes së procedurave të regjistrimit, kjo pronë, njësi, është në përdorim, pa kundërshtim, të vëllait të V. K.. Në rast se nuk bëhet regjistrimi i pronës sipas kushteve të përmendura në deklaratën e heqjes dorë, pronësia mbi këtë njësi i kalon përsëri vëllait të V. K.*
71. Në DIPP-2013, subjekti ka deklaruar: *Pasuri e paluajtshme, numri i pasurisë {***}, adresa {***}, lloji i pasurisë njësi, sipërfaqe totale 61,2 m², vlera 13.500.000 lekë (trembëdhjetë milionë e pesëqind mijë lekë)/ 100.000 (njëqind mijë) euro, data 11.07.2013, pjesa 100%.*

*Dokumente justifikuese të pasurisë së mësipërme: certifikatë për vërtetim pronësie, nr. {***}, data 23.09.2013 – një fletë; kartelë e pasurisë së paluajtshme. Planimetria e pasurisë – tri fletë; deklaratë për heqje dorë nga pronësia nr. rep., {***}, nr. kol. {***}, datë 16.09.2013 – dy fletë; kontratë shitblerje prone pasurie të paluajtshme nr. rep. {***}, kol. {***}, datë 20.09.2013 – tri fletë; certifikatë me vërtetim pronësie, kartelë pasurie, planvendosje objekti në emër të shoqërisë {***} – tri fletë; kontratë porosie për ndërtim ambient shërbimi, datë 11.05.2010, investitori {***}, porositësi V. K. – gjashtë fletë; leje ndërtim objekti, leje shesh ndërtimi, planimetri, kartelë pasurie, planimetri e pasurisë – pesë fletë.*

72. Kjo pasuri rezultoi e regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit, i cili është pajisur me certifikatë pronësie më datë 01.10.2013²¹.
73. Sipas kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.05.2010, me shoqërinë investitore “{***}” ShPK, rezultoi se V. K. ka porositur ndërtimin e një njësie me sipërfaqe totale prej 70,4 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Unaza e Re, Tiranë, me çmim 100.000 euro. Bazuar në parashikimet në këtë kontratë, përcaktohet se porositësi e paguan çmimin prej 100.000 eurosh, në llogarinë e kontraktorit (investitorit) me këste. Në fashikullin e Komisionit, janë administruar pagesat e kryera nga V. K. në shumën 85.000 euro.
74. Përmes deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.09.2013, të nënshkruar midis subjektit Sabri Kastrati dhe vëllait të tij V. K., ky i fundit ka hequr dorë nga vazhdimi i procedurave të hipotekimit të kësaj njësie, duke ia kaluar këtë të drejtë subjektit të rivlerësimit, si dhe të drejtën të nënshkruante kontratën përfundimtare të shitjes me shoqërinë “{***}” ShPK, sipas çmimit të përcaktuar në kontratën e porosisë, likuiduar plotësisht nga V. K. Në këtë akt noterial, specifikohet se heqja dorë bëhet me kushtin që subjekti i rivlerësimit të kalojë në favor të V. K. pasurinë “{***}” në lagjen {***}, Kukës, i cili ishte në proces legalizimi dhe se, pas nënshkrimit të aktit përfundimtar të shitblerjes së “{***}” dhe pajisjes me certifikatë pronësie, V. K. i detyrohet vëllait Sabri Kastrati edhe shumën prej 100.000 eurosh, të cilën do t’ia kalonte në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së “{***}”.
75. Në deklaratën e sipërcituar, subjekti ka deklaruar se, pasi të pajiset me certifikatë pronësie për njësinë e porositur me kontratën e porosisë nr. {***}, datë 11.05.2010, do t’ia japë në përdorim pa kundërshtim vëllait të tij V. K., derisa të nënshkruajnë aktet e kalimit të pronësisë së pasurisë “{***}”²².
76. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se pagesat në lidhje me këtë pasuri, janë kryer nga vëllai i tij, vërtetuar sipas transfertës bankare për shumën 50.000 euro dhe sipas mandatarkëtimeve për shumën 35.000 euro, ndërsa diferenca e mbetur prej 15.000 eurosh është paguar nga vëllai i tij, i cili nuk e disponon mandatarkëtimin përkatës.
77. Komisioni i ka kërkuar subjektit të sqarojë dhe paraqesë dokumentacion justifikues mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait V. K., të cilat kanë shërbyer për blerjen e njësisë

²¹ Drejtoria Vendore e ASHK-së Tiranë Rurale 2, me shkresën nr. prot. {***}, datë 21.03.2024, ka konfirmuar pasurinë njësi me sipërfaqe 61,2 m², me nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, z.k. {***}, të regjistruar në emër të z. Sabri Kastrati.

²² Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2005, subjekti ka deklaruar: “Supermarket, restorant, hotel, garazh (objekt 5-katësh), i ndodhur në Kukës, i quajtur Kompleksi {***}, është në pronësinë time dhe të dy vëllezërve M. dhe V. K., me pjesë takuese 33% dhe vit krijimi 1998”.

në vlerën 100.000 euro. Në lidhje me këtë kërkesë, subjekti ka shpjeguar se vëllai i tij ka pasur aktivitet tregtar si person fizik dhe gjithashtu ka jetuar e punuar edhe në Angli. Për të provuar burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave, subjekti ka depozituar kopje të disa kontratave të tij si person fizik, si edhe gjendjet e llogarive të ndryshme bankare në emër të tij ndër vite.

78. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti ka depozituar dokumentacion lidhur me aktivitetin tregtar në emër të V. K., të regjistruar me vendim gjyqësor nr. {***}, datë 01.03.2007 (me NIPT {***}), me objekt veprimtarie “Tregtim të artikujve të përzier ushqimorë, industrialë, pjesë këmbimi, mobileri, prodhime buke, hotel-restorant”, në lagjen nr. {***}, Kukës. Gjithashtu, subjekti ka depozituar edhe nxjerrje të llogarive bankare të vëllait të tij në Raiffeisen Bank në Shqipëri dhe Lloyd Bank në Angli.
79. Rezulton se, sipas deklaratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.10.2010, subjekti i rivlerësimit Sabri Kastrati dhe dy vëllezërit e tij, M. dhe V. K., kanë deklaruar se janë pronarë të një pasurie të paluajtshme me emërtimin: supermarket, kati I; bar-restorant kati II; kati III dhe IV hotel, pronë e regjistruar në emër të trashëgimlënësit H. K. Deklaruesit kanë shpjeguar se, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e kanë ndarë atë dhe konkretisht, *supermarketi është në pronësi të vëllait M. K., bar-restoranti, në pronësi të Sabri Kastrati dhe dy kate hotel, në pronësi të V.K. [...] Pas përfundimit të procedurave të legalizimit, objekti në fjalë, sipas ndarjeve të lartpërmendura, do të regjistrohet përkatësisht në emrin e pronarëve të lartpërmendur.*
80. Referuar arsytimit të Komisionit në vendimin objekt kontrolli, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka bërë një vlerësim sipërfaqësor në lidhje me marrëdhënien e krijuar midis subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij V. K. Vlerësimi i kësaj marrëdhënieje nuk është i drejtë, pasi nuk bazohet në një hetim dhe konstatim të plotë të situatës faktike lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë “{***}” në Kukës, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit se është shkëmbyer me pasurinë njësi me sipërfaqe 61,2 m², si dhe të analizës mbi marrëdhënien juridiko-civile të krijuar midis subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij, z. V. K. Trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, e konsideron të besueshme marrëdhënien e shkëmbimit të subjektit me vëllain e tij, dhe se mungesa e një kontrate përfundimtare shkëmbimi për shkak të mosregjistrimit të pasurisë së ndodhur në Kukës, nuk nënkupton mosekzistencën reale të kësaj marrëdhënieje.
81. Trupi gjykues vlerëson se marrëdhënia e shkëmbimit të pasurive të paluajtshme nuk bën pjesë në situatat e parashikuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrimin të provojë burimet e ligjshme të vëllait të tij V. K. për pagimin e çmimit të kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.05.2010.
82. Sa më sipër analizuar, lidhur me pasurinë *njësi* me sipërfaqe 61,2 m², ndodhur në {***}, Tiranë, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor mbi të ardhurat e ligjshme të vëllait, që kanë shërbyer për blerjen e njësisë në vlerën 100.000 euro, në kundërshtim me sa parashikon neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur kështu nën parashikimin e shkronjës “b” të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, është i pabazuar në situatën faktike dhe në ligj.

➤ Në lidhje me pasurinë automjet, tip “Mercedes Benz”, me vlerë 500.000 lekë:

83. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se: *subjekti nuk përmbysi të kundërtën e barrës së provës mbi mundësinë financiare për blerjen e automjetit. Për rrjedhojë, subjekti ka pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit, në kuptim të nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe shkronjës “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.*
84. Vlerësimin e tij në lidhje me këtë pasuri, Komisioni e ka bazuar në konstatimet se: *[...] pretendimi i subjektit se nuk ka detyrim të deklarojë gjendjen cash nën shumën 300.000 lekë në vitin paraardhës, nuk qëndron, pasi, në referim të nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, gjendjen cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, depozitë, bono thesari huadhënie, lekë ose valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, nuk ka një limit të përcaktuar në deklarimin e pasurive dhe likuiditeteve nga ana e subjektit, pasi ky kufizim u referohet shpenzimeve të deklarueshme, të cilat duhet të deklarohen mbi vlerën 300.000 lekë, sipas shkronjës “h” të nenit 4 të këtij ligji. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve cash, për të mundësuar në këtë mënyrë kontrollin e pasurisë. Sa i përket pretendimit të subjektit se shpenzimet për mobilimin e shtëpisë në Durrës i janë llogaritur apriori nga Komisioni, pasi nuk e ka deklaruar asnjëherë një shpenzim të tillë, ky pretendim nuk qëndron, pasi në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar qartësisht se vlera totale e arredimit të banesës në Durrës, është afërsisht 500.000 lekë. Referuar këtij deklarimi, si dhe nisur nga fakti se gjatë hetimit subjekti nuk mundi të përcaktonte një periudhë kohore konkrete në të cilën ka kryer mobilimin, Komisioni ka ndarë midis viteve 2008 – 2009 shumën e shpenzuar për arredim, prej 500.000 lekësh.*
85. Subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi si të gabuar vlerësimin e Komisionit, duke pretenduar se qëllimi i ligjit nuk është gjetja e pasaktësive në deklarime ndër vite, por, duke përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, institucionet e rivlerësimit bëjnë hetim të plotë e të gjithanshëm për të parë nëse ka ose jo fshehje pasurie apo mosjustifikim të saj nga ana e subjektit të rivlerësimit. Subjekti pretendon se vendimmarrja e Komisionit është në kundërshtim me praktikën e Kolegjit²³ në lidhje me pasaktësitë në deklarime.
86. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, referuar akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton si në vijim.
87. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Automjet i markës “Mercedes Benz”, targa {***}, blerë në vitin 2009 sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.08.2009²⁴. Burimi i krijimit të kësaj pasurie është nga të ardhurat nga pagat. Vlera e 500.000 lekë, pjesa takuese 100%.*

²³ Subjekti i referohet vendimit nr. 28, datë 23.10.2020, të Kolegjit.

²⁴ Subjekti ka blerë nga shitësi Z. L. automjetin e markës “Mercedes Benz”, me vit prodhimi 2002, në shumën 500.000 lekë, të likuiduar mes tyre nëpërmjet bankës, i cili është regjistruar në pronësi të subjektit Sabri Kastrati, sipas certifikatës së pronësisë së mjetit rrugor, datë 19.3.2010. DPSHTRR-ja ka konfirmuar automjetin me targë {***}, të regjistruar në pronësi të subjektit.

88. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në DIPP-2009, ku subjekti ka deklaruar automjet tip “Benz”, viti 2002, vlera 500.000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit.
89. Komisioni verifikoi mundësinë financiare të subjektit për blerjen e automjetit në datën 05.08.2009, në shumën 500.000 lekë, duke marrë në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet familjare për subjektin, bashkëjetuesen dhe dy fëmijët, për periudhën janar - gusht 2009. Bazuar në rezultatin e analizës paraprake financiare, rezultoi se subjekti, në momentin e blerjes së automjetit, kishte balancë negative fondesh në shumën (-)143.912 lekë. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
90. Në analizë të sa më sipër, sa i takon pretendimit të subjektit se shkak për vlerësimin e Komisionit në lidhje me këtë pasuri, janë bërë pasaktësitë në deklarimet e tij mbi gjendjen *cash* ndër vite, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për deklarimin e likuiditetit *cash*, shtesave apo pakësimeve të tij në fund të çdo viti, pavarësisht vlerës së tyre. Përveç mosdeklarimit të gjendjes *cash* ndër vite, trupi gjykues konstaton se, referuar DIPP-2009, viti i blerjes së këtij automjeti, subjekti nuk rezultoi të ketë deklaruar burimin e krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi apo pakësim të gjendjes *cash* në funksion të blerjes së saj.
91. Trupi gjykues kontrolloi nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, analizën financiare të kryer nga Komisioni për vlerësimin e ligjshmërisë së blerjes në vitin 2009 të këtij automjeti, duke konstatuar se Komisioni ka analizuar drejt mundësinë financiare të subjektit për blerjen e automjetit në datën 05.08.2009, në shumën 500.000 lekë, duke përllogaritur të njëjtën balancë negative në shumën (-) 143.912 lekë.
92. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, lidhur me pasurinë *automjet tip “Mercedes Benz”*, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- *Pasuria apartament me sipërfaqe 68,2 m², në rr. “{***}”, Tiranë:*
93. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e arritur nga Komisioni në përfundim të kontrollit të kësaj pasurie se: *problematikat e konstatuara për këtë pasuri, lidhur me pamundësinë e të ardhurave të ligjshme të prindërve të bashkëjetueses për blerjen e apartamentit, të konsideruara së bashku me problematikat e tjera të kriterit të pasurisë, përbëjnë shkak që subjekti të gjendet nën parashikimet e nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.*
94. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar vlerësimin e Komisionit si të pabazuar në faktet dhe provat e paraqitura prej tij, duke iu dhënë provave një vlerë të paracaktuar dhe në interpretim të gabuar të ligjit. Subjekti i rivlerësimit e ka bazuar shkakun e ankimit në pretendimet e mëposhtme.
95. Bashkëjetuesja e tij nuk ka lidhur kontratë me FSHU-në dhe nënshkrimi i kësaj kontrate nuk është bërë prej saj, fakt i provuar sipas aktekspertimit grafik të paraqitur prej tij në cilësinë e provës, në të cilin është konkluduar se shkrimi dhe nënshkrimi në këtë kontratë nuk është i bashkëjetueses së tij. Subjekti pretendon se i ka kërkuar Komisionit kryerjen e një akti ekspertimi në lidhje me këtë kontratë, me qëllim që të mos paragjykohej vlera e aktit të ekspertimit të paraqitur prej tij, kërkesë e cila nuk është pranuar nga Komisioni.

96. Komisioni, me një qëndrim paragjykses ndaj tij, ka konsideruar provë të nivelit deklarativ aktin e ekspertimit të paraqitur prej tij, si dhe të dhënat sipas sistemit TIMS, në bazë të të cilave provohet se bashkëjetuesja e tij, në kohën e lidhjes së kontratës, ka qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
97. Komisioni ka bërë interpretim të gabuar të nenit 761 të Kodit Civil, i cili parashikon se pranimi i dhurimit duhet të bëhet me një akt të shkruar dhe jo refuzimi i tij.
98. Kontrata e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.08.2014, nuk është nënshkruar nga bashkëjetuesja dhe është një veprim juridik *nul*, absolutisht i pavlefshëm.
99. Bazuar në parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka detyrim ligjor për të paraqitur dokumente justifikuese për ligjshmërinë e burimeve të pasurisë së shtetasve B. dhe L. H., dhe se sqarimet e tij në lidhje me të ardhurat e tyre, janë bërë në kuadër të transparencës.
100. Vendimi i Komisionit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit në vendimin nr. 15, datë 17.07.2019, i cili ka përcaktuar se subjektet e rivlerësimit do të kenë detyrimin për të provuar ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të kanë hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera të marrëdhënieve të interesit, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave.
101. Arsyetimi i Komisionit në lidhje me nënshkrimin e akteve kontratë porosie, kontratë e FSHU-së apo kontratë e UKT-së, është tërësisht i pambështetur në ligj dhe në prova. Subjekti pretendon se ai ka detyrimin ligjor që të provojë se këto akte nuk janë nënshkruar prej tij apo prej personit të lidhur, por nuk ka detyrimin që të gjejë se kush i ka nënshkruar ato. Sipas tij, në rastin konkret, me prova të qarta dhe shkencore, ai ka provuar se kontrata e porosisë dhe kontrata për lidhjen e energjisë elektrike nuk janë nënshkruar prej bashkëjetueses së tij, duke përmbushur në këtë mënyrë barrën e provës sipas ligjit.
102. Trupi gjykses, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjekti të rivlerësimit, konstaton si vijon.
103. Në deklaratën *vetting*, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, bashkëjetuesja e subjekti të rivlerësimit, znj. D. H., ka deklaruar se: *Në janar të vitit 2017 ka marrë dijëni për ekzistencën e një kontrate porosie me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.08.2014, sipas së cilës rezulton se unë, D. H., kam porositur te shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, Tiranë, një apartament banimi me sipërfaqe 68,2 m², në vlerën 61.000 (gjashtëdhjetë e një mijë) euro. Nga data 26.06.2014 e deri më 23.08.2015, kam qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, fakt të cilin e vërtetoj me të dhënat për hyrje-daljet e regjistruara në sistemin TIMS. Meqenëse kjo kontratë ekziston e regjistruar në Regjistrin e Noterit Publik, për këtë arsye bëj këtë deklaram. Kjo kontratë ka qenë e lidhur nga prindërit e mi, B. H. dhe L. H., të cilët, për shkak të rrethanave familjare, kanë vënë emrin e tim si porositëse e kësaj prone. Kjo gjë shpjegohet edhe në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.01.2017, e përpiluar nga prindërit e mi²⁵.*

²⁵ Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, ndodhet dokumentacioni vijues: (1) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.1.2017, nga shtetasit B. dhe L. H., si dhe dokumentet e identifikimit të tyre; (2) kontratë porosie nr. {***}, datë 8.8.2014; (3) raporti i personit D. H. dhe D. K., e datëlindjes 04.05.1978, nga sistemi TIMS; (4)

104. Rezulton se Zyra e Regjistrimit Noterial²⁶ ka dhënë informacion mbi veprimet noteriale të kryera nga znj. D. H. ku, ndër të tjera, evidentohet edhe kontrata e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.08.2014, e redaktuar pranë noterës E. T.
105. Komisioni ka administruar kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.08.2014, sipas së cilës rezulton se porositësja, znj. D. H., dhe i porosituri, shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, kanë rënë dakord për ndërtimin e një apartamenti në rr. “{***}”, 1+1, me sipërfaqe të përgjithshme 68,8 m², në çmimin 61.000 euro. Sipas kësaj kontrate, pagesat do të kryheshin në numrin e llogarisë bankare të shoqërisë, nga të cilat, shuma prej 50.000 eurosh do të paguhej me hartimin e kontratës, shuma prej 10.000 eurosh me mbarimin dhe dorëzimin për banim të apartamentit në gusht të vitit 2015, si dhe 1.000 euro në momentin e hipotekimit dhe hartimit të kontratës së shitjes së apartamentit. Gjithashtu, palët kanë përcaktuar se apartamenti do t’i dorëzohej porositësit brenda datës 31.07.2015, ku porositësi duhet të firmosë procesverbalin e marrjes në dorëzim të tij.
106. Referuar informacionit të ASHK-së Tiranë, kjo pasuri e paluajtshme nuk figuron e regjistruar në pronësi të shtetasës D. H., ndërkohë FSHU-ja ka konfirmuar se në emër të znj. D. H., identifikohet një abonent në instancën Tiranë ku, sipas të dhënave, evidentohet se kontrata e furnizimit është lidhur në datën 11.02.2016, në adresën: “{***}, {***}, Tiranë”, me shënim: “prot. {***}, datë 25.5.2018, S.K”.
107. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.01.2017, prindërit e bashkëjetueses së subjektit, B. dhe L. H., kanë deklaruar se kanë lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK kontratën e porosisë nr. {***}, datë 08.08.2014, për apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”, ku palë porositëse figuron vajza e tyre D. H., e cila në atë kohë nuk ndodhej në Shqipëri, por në Australi. Ata deklarojnë gjithashtu se këtë veprim e kanë kryer për shkak të disa rrethanave familjare në lidhje me djalin e tyre, dhe se këtë fakt nuk ia kanë bërë të ditur vajzës së tyre asnjëherë, pasi e gjykuan të arsyeshme dhe të domosdoshme t’ia bëjnë me dije në këtë moment, për ta përjashtuar atë nga çdo përgjegjësi. Shtetasit B. dhe L. H. deklarojnë se shuma e blerjes së apartamentit është 61.000 euro, nga e cila 50.000 euro është shlyer pranë shoqërisë “{***}” ShPK në momentin e lidhjes së kontratës, shumë e siguruar nga kursimet e tyre familjare, konkretisht znj. L. H. deklaron se ka pasur në Bankën Amerikane (sot Intesa San Paolo Bank) rreth 8.000 USD, ndërsa z. B. H. deklaron se pothuajse prej 10 vitesh ka pasur të depozituara në Alpha Bank dhe NBG Bank kursimet e tij. Më datë 31.07.2014, është

nxjerrje llogari rrjedhëse e shtetasit B. H. në Raiffeisen Bank, e datës 30.01.2017, për periudhën 10.05.2005 – 29.01.2017, në të cilën evidentohen kreditime për pagesë sipas kontratave dhe paga e shpërblime; (5) nxjerrje llogari rrjedhëse e shtetasit B. H. në NBG Bank, e datës 30.01.2017, për periudhën 30.07.2012 – 03.01.2017, si dhe nga data 28.07.2011 deri më 01.08.2014, në të cilën evidentohen kreditime për depozita, të cilat, nga akumulimet, kanë arritur rreth 1.000.000 lekë në vitin 2011, 1.500.000 lekë në vitin 2013, dhe në datën 1.8.2014 është tërhequr shuma 2.000.000 lekë, me përshkrimin: “Dhënie borxhi H. J. K. nga B. H.”; (6) nxjerrje llogari rrjedhëse e shtetasit B. H. në Alpha Bank, e datës 30.01.2017, për periudhën 01.03.2009 – 30.01.2017, në të cilën evidentohet në vitin 2009 mbyllje depozite 1.200.000 lekë dhe çelje më pas depozite 2.000.000 lekë, në vitin 2011 – 2012, depozita bëhet 2.500.000 lekë, në vitin 2013 bëhet 3.500.000 lekë dhe, në datën 31.07.2014, shtetasi B. H. debiton llogarinë në shumën 4.000.000 lekë, me përshkrimin: “B. H. për H. K., dhënie borxhi”; (7) nxjerrje llogarie rrjedhëse e shtetasit B. H. në BKT, e datës 30.01.2017, për periudhën 01.01.2009 – 30.01.2017, në të cilën evidentohen kreditimet nga paga të këtij shtetasi; (8) kontratë depozite në Intesa Sanpaolo Bank, fillimisht e çelur në emër të shtetasës L. H. me shumën 5.914 USD, në maj të vitit 2001, e cila me rinovimet ndër vite arrin në nëntor të vitit 2003 në shumën 10.292 USD (dyemërore L. H. dhe D. H.).

²⁶ Njëpërmjet shkresës nr. prot. {***}, datë 26.07.2021.

transferuar në Alpha Bank shuma 4.000.000 lekë dhe, në datën 01.08.2014, shuma 2.000.000 lekë në NBG, të cilat, pasi janë konvertuar në euro, janë përdorur për blerjen e apartamentit.

108. Referuar të dhënave nga sistemi TIMS, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, rezulton se në emër të D. H. dhe D. K., e datëlindjes 04.05.1978, është regjistruar dalje jashtë Shqipërisë nga D. H. në datën 26.06.2014 (me pasaportë shqiptare) dhe hyrje në Shqipëri nga D. K. (me pasaportë australiane) në datën 23.08.2015.
109. I pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar²⁷ se bashkëshortja e tij nuk ka qenë në dijeni të ekzistencës së kontratës së porosisë së hartuar nga prindërit e saj, të cilët kanë dashur t'ia bëjnë dhuratë, në formë surprize. Subjekti ka sqaruar se ajo nuk ka kryer asnjë veprim tjetër në lidhje me këtë pasuri, e cila, në dijeninë e tyre, nuk është regjistruar pranë ASHK-së. Sipas subjektit, nëse kjo kontratë do të regjistrohej në ASHK, do të duhej të bëhej në formën e kontratës së dhurimit dhe, sipas ligjit, bashkëjetuesja e tij duhet të japë pëlqimin për pranimin e dhurimit, sipas përcaktimeve të nenit 761 të Kodit Civil, fakt i cili nuk ka ndodhur, pasi nga ana e bashkëjetueses së tij nuk është nënshkruar asnjë kontratë dhurimi e, për rrjedhojë, nuk është kryer asnjë veprim për regjistrimin e kësaj kontrate apo pasurie pranë ASHK-së.
110. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për dokumentacion provues mbi pagesat e kryera pranë shoqërisë ndërtuese, subjekti ka sqaruar, ndër të tjera, se kjo banesë është marrë në dorëzim nga nëna e bashkëjetueses, znj. L. H., dhe se në vitin 2021 është paguar prej saj edhe kësti i fundit, dhe se, në dijeninë e tij, pasuria nuk është regjistruar ende në hipotekë dhe nuk është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes.
111. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues aktin e dorëzimit të apartamentit të datës 20.10.2016²⁸, shoqëruar me *procesverbal dorëzimi për apartamentet*, datë 19.10.2016, si dhe mandat bankar, datë 03.06.2021, për pagesën e shumës 11.000 euro nga shtetasja L. H., me përfitues shoqërinë “{***}” ShPK, me përshkrimin: “L. H., blerje apartamenti, kësti i fundit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.08.2014”.
112. Shoqëria “{***}” ShPK, në informacionin e dërguar pranë Komisionit në lidhje me kontratën e porosisë dhe transaksionet e pagesave, me shkresën e datës 23.05.2024, ka informuar se: *Kontrata e porosisë për këtë apartament të prenotuar nga znj. D. H., është në datë 08.08.2014, me nr. rep. {***}, nr. kol {***} kol., nuk është hipotekuar nga ana e D., por është në pronësi të “{***}” ShPK pasi nuk është shlyer plotësisht dhe nuk ka kaluar e drejta e pronësisë nga “{***}” ShPK te D. H., prandaj nuk ka akoma një kontratë shitjeje përfundimtare. Sipas kontabilitetit në sistemin tonë financiar, këto pagesa janë kryer nga znj. L. H., përkatësisht vlerat 3.600.000 lekë dhe 10.000 euro. Bashkëlidhur kësaj shkrese nuk ka dokumentacion provues në lidhje me pagesat e kryera.*
113. Nisur nga deklaratimet e shtetasës D. H. në deklaratën *vetting*, si dhe deklaratimet e prindërve të saj në deklaratën noteriale, datë 29.01.2017, Komisioni ka analizuar burimet e ligjshme të prindërve, nëse do të kishin mundësi financiare, me të ardhurat e tyre, për blerjen e kësaj pasurie.

²⁷ Në shpjegimet e depozituara më datë 30.10.2023, në përgjigje të pyetësorit të datës 20.10.2023.

²⁸ Ky akt rezulton të jetë firmosur nga përfaqësuesi i shoqërisë “{***}” ShPK, inxhinieri i firmës/arkitekti.

114. Lidhur me depozitën në shumën 8.000 USD pranë Intesa Sanpaolo Bank, referuar të dhënave bankare, Komisioni ka konstatuar një depozitë bankare në monedhën USD, në emër të shtetaseve D. H. dhe L. I.²⁹, çelur në datën 23.11.2003 dhe mbyllur në datën 09.10.2008. Kjo depozitë fillimisht është çelur në emër të shtetasës L. H. me shumën 5.914 USD, në maj të vitit 2001³⁰, e cila në datën 31.12.2007 arrin në shumën 8.733 USD dhe tërhiqet dhe mbyllet në vitin 2008 në shumën 8.876 USD nga shtetasja D. H. Në të njëjtën bankë, ka rezultuar edhe një depozitë e çelur në datën 05.05.2003, në emër të shtetaseve L. dhe D. H., në shumën 10.292 USD. Kjo shumë është mbajtur në depozitë deri në muajin nëntor 2003, kur është tërhequr dhe mbyllur. Nga verifikimi i deklarimeve periodike për periudhën 2005 - 2007, bashkëjetuesja e subjektit nuk ka deklaruar depozitën e kursimit të përbashkët me nënën e saj pranë Intesa Sanpaolo Bank.
115. Referuar sa më sipër, në kushtet kur bashkëjetuesja e subjektit figuron mbajtëse e llogarisë së depozitës dhe ka kryer veprime në periudhën 2003 – 2008, Komisioni i ka kërkuar subjektit të deklarojë nëse ka kontribute në krijimin e kësaj depozite, masën e kontributit të saj, si dhe të dokumentojë burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Subjekti ka sqaruar se kjo llogari është mbyllur në vitin 2008 dhe këto para janë mbajtur *cash* në banesë nga nëna e saj dhe, më pas, janë përdorur në vitin 2014 për blerjen e apartamentit. Subjekti ka shpjeguar se bashkëjetuesja e tij nuk ka kontribuar në krijimin e kësaj depozite dhe as ka përfutuar ndonjë shumë nga kjo depozitë, por veprimet e kryera nga ana e saj, kanë qenë për shkak të pamundësisë fizike të nënës së saj për të kryer veprime bankare³¹.
116. Komisioni kreu analizën financiare mbi të ardhurat e ligjshme të prindërve të bashkëjetueses në vite, duke filluar nga viti 1998 deri në vitin 2001, kur është hapur depozita në emër të L. H., fillimisht në shumën 7.500 USD. Në analizë u morën në konsideratë të ardhurat nga paga dhe pensionet e L. dhe B. H., shpenzimet e jetesës për dy persona, të ardhurat nga shitja e një prone në vitin 2000, në shumën 1.400.000 lekë, si dhe depozitat bankare, nga ku rezultoi se prindërit e bashkëjetueses nuk kanë pasur mundësi për të krijuar depozitën deri në fund të vitit 2001, duke rezultuar me një balancë negative në shumën (-) 2.477.626 lekë.
117. Lidhur me shumat 4.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë, kursime në llogari të B. H., nga verifikimi i të dhënave bankare pranë Alpha Bank, Komisioni ka konstatuar se në datën 31.07.2014, është transferuar një shumë prej 4.000.000 lekësh midis 2 llogarive pranë Alpha Bank, me përshkrimin: “Sa kaluar nga B. për H. K., dhënie borxhi”. Nga verifikimi i të dhënave bankare pranë ABI Bank, evidentohet se në datën 01.08.2014, është kryer transferimi i shumës 2.000.000 lekë nga B. H. te shtetasit J. H. K., me përshkrimin: “Dhënie borxhi nga B. H.”.
118. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimin dokumentacion provues mbi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e shumave 4.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë, të depozituara në

²⁹ Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 03.08.2021, të Intesa Sanpaolo Bank, mbiemri i saj referohet I., i cili, sipas të dhënave nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, është mbiemri i vajzërisë.

³⁰ Deri në nëntor 2001, Intesa Sanpaolo Bank referon se kjo depozitë është në shumën 7.500 USD.

³¹ Dokumentacion i depozituar nga subjekti me nr. prot. {***}, datë 20.05.2024: (1) statement bankar i L. H. nga Intesa SanPaolo Bank për periudhën 01.01.2014- 26.01.2017; (2) Deposit Credit Advice nga Intesa SanPaolo Bank mbi veprimet e kryera në llogarinë e depozitës; (3) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga Drejtoria e Shëndetit Publik Elbasan për L. H., për periudhën 01.01.1994- 08.11.1999; (4) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë për L. H., për periudhën 01.01.2000- 30.06.2009

llogari nga shtetasi B. H., për të cilat subjekti ka shpjeguar se këto shuma janë kursime ndër vite të këtij shtetasi dhe, për sa kohë bashkëjetuesja nuk e ka pranuar dhurimin e kësaj banese, në bazë të ligjit nr. 84/2016, ai nuk ka detyrim për justifikimin e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave. Subjekti ka sqaruar gjithashtu se transfertat e shumave 4.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë kanë pasur për qëllim këmbimin e tyre në euro dhe jo dhënien e huasë sipas përshkrimit. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka depozituar akte shkresore për të ardhurat e shtetasit B. H. në vite³², si dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.06.2024, përmes së cilës shtetasi H. K. ka deklaruar se shtetasi B. H. i ka transferuar atij dhe babait të tij të ndjerë J. K., shumat 4.000.000 lekë, 2.000.000 lekë dhe 8.000 USD, me qëllim këmbimin në euro, për arsye sigurie, pasi kursi i këmbimit në banka ishte më i lartë.

119. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet se:

(i) Ka deklarime kontradiktore nga shtetasja D. H. pasi, nga aktet e administruara, ka rezultuar se kjo shtetase në datën 11.02.2016, ka lidhur kontratën e furnizimit me energji elektrike me FSHU-në, ndërsa në deklaratën *vetting* deklaron se ka marrë dijëni në lidhje me kontratën e porosisë në janar të vitit 2017.

(ii) Ngrihen dyshime lidhur me vërtetësinë e vetëdeklarimeve të shtetasës D. H. se pasuria apartament është porositur nga prindërit e saj, pasi: a) nga të dhënat bankare, ka rezultuar se likuiditetet në depozitat e prindërve, shumat 4.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë nuk janë përdorur për blerjen e apartamentit, por janë transferuar me përshkrimin “dhënie borxhi”, palëve të treta; b) shuma e depozitës 8.000 USD është tërhequr në vitin 2008 nga shtetasja D. H., ndërsa apartamenti është porositur në vitin 2014, pas 6 vitesh; c) nuk provohen pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie te shoqëria “{***}” ShPK, edhe pse në kontratën e porosisë përcaktohet se ato do të kryheshin në numrin e llogarisë në bankë të kësaj shoqërie.

(iii) Ka mospërputhje deklarimesh në lidhje me pagesat e kryera për apartamentin pasi shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK informon se nuk janë shlyer plotësisht detyrimet për blerjen e apartamentit, nga ku janë paguar 3.600.000 lekë dhe 10.000 euro, ndërsa subjekti ka deklaruar se në vitin 2021 është paguar kësti i fundit i apartamentit, prej 11.000 eurosh, duke depozituar procesverbal dorëzimi të apartamentit, datë 19.10.2016, çka tregon likuidim total të pagesave.

³² Dokumentacion i depozituar nga subjekti me nr. {***} prot., datë 20.05.2024: (1) kontrata e hapjes së depozitës me afat pranë Alpha Bank, për shumën 2.000.000 lekë, në datën 14.07.2009 (me afat maturimi 14.07.2010); (2) kontrata e hapjes së depozitës me afat pranë Alpha Bank, për shumën 2.000.000 lekë, në datën 14.07.2010 (me afat maturimi 14.07.2011); (3) kontrata e hapjes së depozitës me afat pranë Alpha Bank, për shumën 2.500.000 lekë, në datën 14.07.2011 (me afat maturimi 16.07.2012); (4) kontrata e hapjes së depozitës me afat pranë Alpha Bank, për shumën 2.500.000 lekë, në datën 16.07.2012 (me afat maturimi 16.07.2013) dhe pasqyra e veprimeve bankare; (5) kontrata e hapjes së depozitës me afat pranë Alpha Bank, për shumën 3.500.000 lekë, në datën 16.07.2013 (me afat maturimi 16.07.2014); (6) nxjerrje llogarie e B. H., lëshuar nga Alpha Bank për periudhën 01.03.2009- 30.01.2017; (7) mandate arkëtimi të NGB Bank, për depozitimin e shumave nga B. H., konkretisht shuma 337.000 lekë në datën 30.07.2012, shuma 1.000.000 lekë në datën 28.07.2010 dhe shuma 1.000 lekë në datën 30.07.2012; (8) kontratë për depozitën bonus, të lidhur në datën 28.07.2010 me NGB Bank për shumën e depozitës 1.000.000 lekë (me afat maturimi 28.07.2011); (9) kontratë për depozitën “E ardhura mujore”, datë 29.07.2011, e lidhur me NGB Bank për shumën 1.104.949 lekë (me afat maturimi 29.07.2012); (10) kontratë për depozitën “E ardhura mujore”, datë 30.07.2012, e lidhur me NGB Bank për shumën 1.500.000 lekë (me afat maturimi 30.07.2013); (11) statement llogarie i NGB Bank mbi veprimet bankare të B. H. për periudhën 28.07.2011 - 01.08.2014 dhe periudhën 30.07.2012 - 03.01.2017; (12) statement llogarie i B. H., lëshuar nga BKT në datën 30.01.2017, për periudhën 01.01.2009 - 30.01.2017; (13) nxjerrje llogarie për B. H., e lëshuar në datën 30.01.2017 nga Raiffeisen Bank, për periudhën 10.05.2005 - 29.01.2017.

(iv) Duket se prindërit e shtetasës D. H. nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e apartamentit, pasi kanë rezultuar me pamundësi financiare për krijimin e depozitave, me një balancë negative në shumën totale (-) 2.477.626 lekë, deri në vitin 2001.

120. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti ka parashtruar të njëjtat argumente dhe pretendime sikurse në ankim.
121. Në analizë të sa më sipër konstatuar, lidhur me krijimin e marrëdhënies mes bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit, znj. D. H., dhe shoqërisë “{***}” ShPK, trupi gjykues arriti në konkluzionin se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë marrëdhënie, nuk arritën nivelin e të shpjeguarit bindshëm në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
122. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion, bazuar në konstatimin se bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit ka qenë palë dhe ka nënshkruar kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.08.2014, ekzistenca dhe vlefshmëria e së cilës është konfirmuar edhe nga noterja E. T., e cila, në përgjigje ndaj kërkesës së Komisionit³³, më datë 08.08.2024, ka vënë në dispozicion një kopje të njëzuar me origjinalin të kontratës së porosisë objekt shqyrtimi, së bashku me kopje të kartave të identitetit të përfaqësuesit të shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e të porositurit, si dhe znj. D. H. në cilësinë e porositësit.
123. Referuar përmbajtjes së kontratës së porosisë, notere E. T., e cila ka kryer identifikimin e palëve, rezulton të jetë shprehur se: *porositësi, znj. D. H. [...] e panjohur prej meje, por për identitetin e saj u njoha me kartën e identitetit me nr. {***}, dhe i porosituri, shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori i saj z. S. K. [...], njohur personalisht prej meje, me kartë identiteti nr. {***}[...], të cilët më deklaruan se [...].* Sa më sipër, bazuar në kërkesat e interpretimit të kontratave, parashikuar nga nenet 681 - 689 të Kodit Civil, shprehja e noterit “*të cilët më deklaruan se*”, provon faktin e paraqitjes së palëve para noterit, duke përjashtuar pretendimin e subjektit në lidhje me nënshkrimin e kontratës së porosisë.
124. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë verifikuar nëpërmjet ndonjë akti ekspertimi nëse nënshkrimi në kontratën e porosisë së sipërcituar është ose jo i bashkëjetueses së tij, sikurse ka bërë me kontratën me UKT-në, por është mjaftuar vetëm në pretendimin se, sipas të dhënave në sistemin TIMS, bashkëjetuesja e tij nuk ndodhej në Shqipëri ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate.
125. Akt ekspertimi i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të pretendimeve të tij, se kontrata e FSHU-së nuk është nënshkruar nga znj. D. H., nuk ka vlerë provuese, pasi ai nuk lidhet me këtë kontratë, por me kontratën e UKT-së.
126. Sa u takon pagesave të kryera për këtë pasuri, sipas kontratës së porosisë, rezulton se vlera 50.000 euro është paguar nga znj. D. H. me hartimin e kontratës së porosisë, ndërsa shuma prej 10.000 eurosh do të paguhej në dorëzimin e apartamentit në muajin gusht të vitit 2015. Bazuar në informacionin e dhënë më datë 27.05.2024³⁴ nga shoqëria “{***}” ShPK, kjo shoqëri ka informuar se, sipas kontabilitetit në sistemin e saj financiar, këto pagesa janë kryer nga shtetasja L. H. në shumat 3.600.000 lekë dhe 10.000 euro, megjithatë nuk rezulton të ketë paraqitur

³³Në kërkesën nr. {***} prot., datë 19.03.2024 si dhe nr. {***} prot., datë 9.4.2024, Komisioni i ka kërkuar noteres E. T. kopje të njëzuar me origjinalin të aktit noterial kontratë e porosisë nr. {***} prot., nr. {***} kol., datë 08.08.2014, si dhe informacion mbi palët që kanë nënshkruar këtë kontratë të redaktuar prej saj.

³⁴Përcjellje nëpërmjet e-mailit të shkresës së datës 23.05.2024 të shoqërisë “{***}” ShPK.

mandatpagesa përkatëse për likuidimin e këtyre shumave apo të ketë referuar transferta bankare në lidhje me likuidimin e kontratës së porosisë.

127. Ndërkohë, prindërit e znj. D. H., në deklaratën noteriale të lëshuar prej tyre për efekt të procesit të rivlerësimit më datë 29.01.2017, kanë deklaruar shlyerjen e pagesës në vlerën 50.000 euro në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë, ndërsa shumën prej shumën 11.000 eurosh në vitin 2021, vërtetuar sipas veprimit bankar të kryer më datë 03.06.2021.
128. Referuar dokumentit “Akt dorëzimi apartamenti” të datës 20.10.2016, të përpiluar nga shoqëria “{***}” ShPK dhe të firmosur nga administratori i kësaj shoqërie dhe nga ing. E. V. dhe ark. A. K., paraqitur nga subjekti me qëllim për të provuar pagesat e kryera për këtë apartament dhe marrjen në dorëzim të tij, thuhet se: *znj. L. H. ka shlyer detyrimet për apartamentin 1+1, në seksionin 4, në katin e katërt të banimit, me sipërfaqe 68,8 m², të përpilohet procesverbali i dorëzimit të apartamentit dhe çelësave, të mbarohen menjëherë punimet e mbetura dhe të merren masa për banim. Ka mbetur vetëm garancia e hipotekës.*
129. Nga sa më sipër, konstatohen mospërputhje midis kontratës së porosisë së datës 08.08.2014, në të cilën është parashikuar se shuma prej 50.000 eurosh është paguar nga bashkëjetuesja e subjektit, informacionit të dhënë nga shoqëria ndërtuese të datës 23.05.2024, sipas të cilit pagesat janë kryer nga shtetasja L. H. në shumat 3.600.000 lekë dhe 10.000 euro, pa përcaktuar kohën e kryerjes së tyre, si dhe deklaratës noteriale të prindërve të bashkëjetueses së subjektit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.01.2017, sipas së cilës shuma prej 50.000 eurosh është paguar prej tyre në datën e lidhjes së kontratës së porosisë, 08.08.2014.
130. Bazuar në analizën e mësipërme, rezulton se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor për deklarimin si të falsifikuar të kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.08.2014, nga përmbajtja e së cilës rezulton se përpara noterit publik është paraqitur personalisht bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor për deklarimin të falsifikuar të kontratës së FSHU-së; (iii) nuk përputhen deklaratimet e shoqërisë ndërtuese me deklaratimet e prindërve të bashkëjetueses së subjektit lidhur me shumën e paguar për këtë apartament.
131. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se kontrata e porosisë e datës 08.08.2014, është lidhur nga bashkëjetuesja e subjektit dhe pagesa prej 50.000 eurosh është bërë prej saj ditën e nënshkrimit të kontratës.
132. Trupi gjykues vlerëson se, nëpërmjet deklaratimit të bërë në deklaratën *vetting* nga bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit dhe shpjegimeve që ky i fundit ka dhënë gjatë procesit në Komision, lidhur me pagesën e shumës 50.000 euro, sipas kontratës së porosisë së datës 08.08.2014, subjekti i rivlerësimit i është shmangur detyrimit të parashikuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë se bashkëjetuesja e tij ka pasur burime financiare të ligjshme për pagesën e shumës 50.000 euro në datën 08.08.2014.
133. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se, lidhur me pasurinë *apartament me sipërfaqe 68,2 m²*, në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

➤ Në lidhje me përlllogaritjen e gjendjes cash në shumat 5.000 euro dhe 100.000 lekë:

134. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e Komisionit se: *subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë të kundërtën e barrës së provës, duke u gjendur në parashikimet e shkronjës “b” të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*
135. Lidhur me deklarimin e gjendjes cash, Komisioni ka vlerësuar në vendim se: *pretendimet e subjektit se nuk ka pasur detyrim për të deklaruar kursimet cash nën shumën 300.000 lekë, nuk mund të pranohen dhe se nuk ka vend për të parashtruar paaftësi për të kuptuar ligjin nga magjistratët, pasi ligji nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ka përcaktuar qartësisht detyrimin e subjekteve për të deklaruar çdo lloj pasurie, si dhe gjendjen e likuiditeteve cash, pa vendosur kufizime në vlerë. Komisioni konstaton se subjekti është kontradiktor në deklarimet e tij, pasi në prapësime pretendon se shpenzimi i mobilimit në shumën 80.000 lekë është llogaritur a priori, pretendim i cili nuk qëndron, pasi gjatë hetimit, vetë subjekti ka deklaruar në pyetësorin standard se, për banesën në Durrës, përveç shpenzimeve për kuzhinën në vlerën 80.000 lekë, në vitin 2016, nuk ka bërë shpenzime të tjera, pasi mobiliet janë zëvendësuar me ato që kishin.*
136. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se vlerësimi i Komisionit është i pabazuar në prova dhe ligj. Shkakun e ankimit, subjekti e ka bazuar në pretendimin se nuk ka pasur detyrim që të deklarojë gjendjen cash nën shumën 300.000 lekë dhe, sipas tij, Komisioni ka përlllogaritur në analizë financiare shpenzime udhëtimi më të larta se ato faktike, si dhe shpenzimet e mobilimit në shumën 80.000 lekë në vitin 2008³⁵ janë përlllogaritur a priori. Sipas subjektit, edhe nëse arsyetimi i Komisionit në lidhje me gjendjen cash do të qëndronte, bazuar në parimin e proporcionalitetit, si dhe në jurisprudencën e deritanishme të Komisionit dhe të Kolegjit, kjo situatë nuk është e tillë që të mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi për vlerësimin e kriterit të pasurisë.
137. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit në raport me arsyetimin e vendimit objekt kontrolli dhe pretendimet e subjekti të rivlerësimit, konstaton si vijon.
138. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar gjendje cash nga kursimet në shumat 5.000 euro dhe 100.000 lekë. Nga verifikimi i deklarimeve periodike ndër vite, evidentohet se kjo gjendje cash vjen e mbartur nga viti 2016, ku në DIPP-në e këtij viti subjekti ka deklaruar gjendje cash nga kursimet, në shumat 5.000 euro dhe 100.000 lekë, ndërsa gjatë periudhës 2004 – 2015, subjekti nuk ka deklarime të kursimeve cash, përveçse në DIPP-2007, ku gjendja cash në banesë deklarohet në shumën 750.000 lekë. Referuar analizës financiare për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme. Po ashtu, kursimet cash të deklaruara në këtë vit, subjekti pretendon t’i ketë përdorur për blerjen e apartamentit në {***}, Durrës.
139. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektit të saktësojë periudhën e krijimit të kursimeve cash, si dhe të depozitojë dokumentacion provues për burimin e krijimit të tyre, për të cilat subjekti ka shpjeguar se këto shuma janë kursime familjare ndër vite, të krijuara me të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëjetueses, nga aktiviteti privat i saj i përkthimeve.

³⁵ Në ankim subjekti e ka referuar vitin 2008, por në pyetësorin standard ka deklaruar mobilimin e kuzhinës në vitin 2016.

140. Bazuar në faktin se subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* nga viti 2008 deri në 2016, Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësinë e krijimit me burime të ligjshme të këtyre kursimeve, duke e përlogaritur të gjithë shumën *cash* si të kursyer në vitin 2016, sipas së cilës ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për krijimin e kursimeve *cash*, duke rezultuar me një balancë negative në shumën (-) 338.813 lekë. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit parashtroi të njëjtat argumente sikurse edhe në ankim.
141. Sa më sipër, në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi detyrimin për deklarim të gjendjes *cash* ndër vite, trupi gjykues, ashtu sikurse edhe Komisioni, e gjen të pambështetur në ligj pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka pasur detyrim për të deklaruar gjendjen *cash* nën shumën 300.000 lekë.
142. Në lidhje me pretendimin e subjektit se shpenzimet e udhëtimit të deklaruara nga ana e tij, kanë qenë në shumën 3.450 euro dhe jo në shumën prej 514.026 lekësh, siç janë përlogaritur nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se, në pyetësin standard subjekti ka deklaruar: *Në datat 15.06.2016 – 22.06.2016, kam udhëtuar në Antalia, Belek. Paketë turistike; hoteli ku kemi qëndruar të gjithë si familje, ka qenë “{***}”. Paketa turistike ka kushtuar rreth 2.100 euro. Pagesa e udhëtimit është përballuar nga të ardhurat e mia dhe të bashkëjetueses. Në datat 4.11.2016 – 6.11.2016, Dubrovnik, Mal i Zi. Paketë turistike; hoteli ku kemi qëndruar të gjithë si familje ka qenë “{***}”. Shpenzimet për këtë udhëtim, kanë qenë 450 euro. Pagesa e këtyre udhëtimeve është përballuar nga të ardhurat e mia dhe të bashkëjetueses. Në datat 15.09.2016 – 17.09.2016, Amsterdam. Udhëtim në Holandë. Shpenzimet për këtë udhëtim, kanë qenë rreth 1000 euro. Në kthim nga Amsterdami, për shkak të humbjes së fluturimit, kemi qëndruar një natë në Romë, hotel “{***}”. Pagesa e udhëtimit është përballuar nga të ardhurat e mia dhe të bashkëjetueses.*
143. Në përgjigjet e pyetësit nr. 3, në lidhje me udhëtimin në datat 18.03.2016 - 21.03.2016, subjekti ka shpjeguar: *Kam qenë tranzit për në Londër, ku kam shkuar të vizitoj të afërmit e mi. Kam qëndruar në shtëpinë e tyre. Shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga të ardhurat familjare. Shpenzime udhëtimi, bileta 200 euro; shpenzime qëndrimi hotel, 100 paund.*
144. Sa më sipër, rezulton se subjekti ka deklaruar shpenzimet e udhëtimit në shumat 3.750 euro dhe shumën 100 GBP dhe jo shumën e pretenduar në ankim prej 3.450 eurosh, për rrjedhojë ky pretendim nuk qëndron.
145. Në lidhje me pretendimin e subjektit për shpenzimet e mobilimit, rezulton se gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka deklaruar në pyetësin standard se: *Për banesën në Durrës, përveç shpenzimeve për kuzhinën në vlerën 80.000, të bërë në vitin 2016, nuk kam bërë shpenzime të tjera pasi mobiliet janë zëvendësuar me ato që kishim.* Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi ky shpenzim rezulton të jetë deklaruar nga vetë subjekti.
146. Bazuar në sa më sipër, pas kontrollit të analizës financiare për vitin 2016, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruara në DIPP-2016 dhe në deklaratën *vetting*, duke rezultuar me një balancë negative në shumën 338.813 lekë.
147. Në përfundim të kësaj analize, si dhe pasi kreu verifikimet e nevojshme nëpërmjet Njësisë së

Shërbimit Ligjor, trupi gjykues vlerëson se, lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e këtij likuiditeti, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

➤ *Në lidhje me analizën financiare:*

148. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2005-2016³⁶, duke pretenduar se: (i) Për vitin 2006, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e ligjshme, dhënë nga vëllai i tij M. K. (ii) Për vitin 2007, Komisioni ka përllogaritur balancë negative në shumën prej (-) 970.870 lekësh, pa i komunikuar atij analizën e hollësishme në lidhje me këtë rezultat. Kjo balancë negative, sipas subjektit, ka ardhur si pasojë e përllogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit në shumën prej 1.517.940 lekësh, të cilat Komisioni i ka shtuar padrejtësisht në analizë, si dhe të shumës prej 250.000 lekësh që Komisioni ka përllogaritur si shpenzime mobilimi në këtë vit. (iii) Për vitin 2013, balanca negative vjen për shkak të përllogaritjes nga Komisioni të vlerës së pasurisë njësi me sipërfaqe 61,2 m², ndodhur në {***}, e cila nuk është shumë e shpenzuar prej tij dhe duhet të zbritet nga analiza financiare. (iv) Për vitin 2014, balanca negative në shumën (-) 8.319.404 lekë vjen si pasojë e përllogaritjes në analizë të vlerës së pasurisë që prindërit e bashkëjetueses së tij kanë shpenzuar për pasurinë apartament në {***}, e cila, sipas tij, duhet të zbritet nga analiza financiare e këtij viti. (v) Për vitin 2015, Komisioni ka konkluduar se balanca negative është në masën (-) 264.800 lekë, pavarësisht se për këtë vit, nga ana e Komisionit, është marrë në konsideratë fakti se shpenzimet e qëndrimit në Australi janë përballuar nga shtetasja A. A. Sipas subjektit, mbetet e paqartë balanca negative për këtë vit, duke qenë se në vendim nuk janë arsyetuar në mënyrë analitike shpenzimet e vitit. (vi) Për vitin 2016, balanca negative e përllogaritur nga Komisioni, në shumën (-) 338.813 lekë, është e gabuar dhe vjen si rezultat i përllogaritjes së shpenzimeve më të larta të jetesës në krahasim me vitin 2015. Subjekti pretendoi gjithashtu se Komisioni nuk ka një analizë të detajuar financiare për periudhën e rivlerësimit.
149. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, pas verifikimit të akteve të fashikullit, si dhe kontrollit të ushtruar nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor analizës financiare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si më poshtë.
150. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për analizën financiare të vitit 2006, lidhen me shkakun e ankimit për përfitimin nga ana e tij të shumës 48.000 euro, dhënë nga vëllai i tij M. K. në vitin 2006, analizuar në mënyrë të detajuar në shkakun e ankimit që lidhet me pasurinë apartament më sipërfaqe 76 m² në rrugën “{***}”, Tiranë.
151. Pretendimi për analizën financiare të vitit 2013, lidhet me shkakun e ankimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit për pasurinë njësi me sipërfaqe 61,2 m², ndodhur në {***}, Tiranë, trajtuar dhe analizuar më sipër në këtë vendim, ku trupi gjykues ka vlerësuar se përfitimi i kësaj pasurie ka ardhur si pasojë e marrëdhënies së shkëmbimit dhe, si rrjedhojë, çmimi prej 100.000 eurosh nuk duhet të përllogaritet në analizën financiare si shpenzim i subjektit të rivlerësimit dhe, si pasojë, analiza financiare e këtij viti rezulton të jetë pozitive.

³⁶ Sipas tabelës së përgjithshme të analizës financiare për periudhën 2005-2016, në faqen 41 të vendimit të Komisionit.

152. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për vitin 2014, lidhen me analizën dhe trajtimin e shkakut të ankimit për pasurinë apartament me sipërfaqe 68,2 m², ndodhur në rrugën “{***}”, trajtuar në mënyrë të detajuar në atë shkak ankimi.
153. Për këtë arsye, trupi gjykues nuk gjen shkak të rikthehet në shqyrtimin e secilit prej tyre dhe i konsideron të konfirmuara arsyetimet e dhëna më sipër.
154. Subjekti pretendon se shpenzimet e mobilimit për vitin 2007, janë përlllogaritur gabim nga Komisioni. Rezulton se Komisioni në paragrafin nr. 26.39 të vendimit, ka arsyetuar se: *Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se vlera totale e arredimit të apartamentit në Tiranë, është afërsisht 500.000 lekë. Sipas deklarimeve të tij, ka filluar të banojë në këtë apartament në vitin 2007. Shpenzimet e mobilimit janë reflektuar në analizën financiare në periudhën 2006 – 2007, meqenëse dorëzimi i apartamentit është në qershor të vitit 2006. Nga verifikimi i përgjigjeve të dhëna në përgjigje të pyetësit standard³⁷, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: Vlera totale e arredimit të banesës në Tiranë është afërsisht 500.000 (pesëqind mijë) lekë.*
155. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vëren se vetë subjekti e ka deklaruar këtë shumë si të shpenzuar për mobilimin e apartamentit në Tiranë, pasuri e blerë nga subjekti në vitin 2006, në të cilin, sipas deklarimeve të tij, ka filluar të banojë në vitin 2007. Në kushtet kur subjekti nuk ka përcaktuar se sa ka qenë shuma e shpenzuar për çdo vit për mobilimin, as në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit dhe as në ankim, përlllogaritja e Komisionit në shuma të barabarta të shpenzimeve të mobilimit prej 250.000 lekësh për vitet 2006 dhe 2007, vlerësohet e drejtë. Nga ana tjetër, edhe nëse do të konsiderohej se e gjithë shuma prej 500.000 lekësh do të ishte shpenzuar në vitin 2006, vit kur është blerë pasuria, balanca negative në shumën prej (-) 6.316.352 lekësh për vitin 2006, do të rritej me 250.000 lekë dhe po ashtu viti 2007 do të pakësohej me këtë shumë, duke u përlllogaritur balancë negative në shumën (-) 720.870 lekë.
156. Në analizë të pretendimit të subjektit në lidhje me përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2007, trupi gjykues konstaton se, referuar rezultateve të hetimit, Komisioni ka përlllogaritur në këtë vit shpenzime për udhëtime në shumën prej 1.745.940 lekësh, shpenzimeve për mobilim në shumën prej 250.000 lekësh, si dhe shpenzime jetike në shumën 609.584 lekë, në total shpenzimet janë përlllogaritur në shumën 2.605.524 lekë. Në tabelën e përgjithshme të analizës financiare për periudhën 2005-2016, në faqen 41 të vendimit, rezulton se Komisioni ka përlllogaritur shpenzimet totale për vitin 2007, në shumën 1.627.242 lekë, duke zbritur shumën prej 978.282 lekësh. Nga kontrolli i kryer në Kolegj nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues konstaton se kjo zbritje ka ardhur si rezultat i pakësimit të zërit të shpenzimeve të udhëtimit nga 1.745.940 lekë në 767.658 lekë³⁸, pasi zërat e shpenzimeve jetike dhe të shpenzimeve të mobilimit kanë mbetur të pandryshuara. Sa më sipër, pretendimi i subjektit se nuk i janë zbritur shpenzimet e udhëtimit në vitin 2007, nuk qëndron.

³⁷ Në përgjigje të pyetjes nr. 14 të këtij pyetësi.

³⁸ Nga përgjigjet e dhëna në pyetësorë, subjekti ka deklaruar se për vitin 2007, ka shpenzuar për bileta në këtë vit, shumën totale prej 5.450 eurosh. Referuar ditëve të udhëtimit në Australi nga subjekti dhe familja e tij, u përlllogarit shuma 1.245 euro si shpenzime qëndrimi [(93 ditë + 93 ditë + 31 ditë + 32 ditë = 249 ditë) x 5 euro/ditë = 1.245 euro], dhe në total u përlllogarit shuma prej 6.695 eurosh (5.450 euro + 1.245 euro = 6.695 euro) si shpenzime udhëtimit për vitin 2007, e konvertuar në shumën 809.492 lekë, vlerë kjo më e lartë se Komisioni i cili ka përlllogaritur shumën 767.658 lekë.

157. Sa i takon pretendimit të subjektit në lidhje me shpenzimet e udhëtimit në Australi, në vitin 2015, trupi gjykues konstaton se, në rezultatet e hetimit, Komisioni ka përllogaritur shpenzime udhëtimit në shumën prej 4.267.150 lekësh, shpenzime të shkollimit në shumën prej 300.000 lekësh, si dhe shpenzime jetike në shumën 448.552 lekë, duke përllogaritur shpenzime totale në shumën 5.214.854 lekë. Referuar tabelës së përgjithshme të analizës financiare për periudhën 2005 - 2016, rezulton se Komisioni përfundimisht ka përllogaritur shpenzimet totale të vitit 2015 në shumën 2.340.722 lekë, duke zbritur nga shuma totale e shpenzimeve për këtë vit, shumën prej 2.874.132 lekësh. Nga kontrolli i ushtruar në Kolegj nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, trupi gjykues konstaton se kjo zbritje ka ardhur si rezultat i pakësimit të zërit të shpenzimeve të udhëtimit nga 4.267.150 lekë në 1.393.018 lekë³⁹. Sa më sipër, pretendimi i subjektit se nuk i janë zbritur shpenzimet e udhëtimit në vitin 2015, nuk qëndron.
158. Sa i takon pretendimit të subjektit se për vitin 2016, Komisioni ka dyfishuar shpenzimet e jetesës në krahasim me vitin 2015, trupi gjykues konstaton se, referuar rezultateve të hetimit, konstatohet se për vitin 2016, shpenzimet e jetesës janë përllogaritur në shumën prej 940.368 lekësh, shumë e cila është përllogaritur në përputhje me të dhënat e INSTAT-it për familje me përbërje familjare prej 4 personash. Shpenzimet e jetesës për vitin 2016 janë më të larta se ato të vitit 2015 pasi, referuar analizës financiare për vitin 2015, rezulton se Komisioni për këtë vit, ka përllogaritur gjysmën e vlerës së shpenzimeve të jetesës, për shkak se familjarët e subjektit kanë qenë në Australi⁴⁰. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për përllogaritje të gabuar të shpenzimeve të jetesës në analizën financiare të vitit 2016, është i pabazuar.
159. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për periudhën e vlerësimit 2005-2016, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultuan me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera për vitet 2006, 2007, 2009, 2014, 2015 dhe 2016, respektivisht në shumat (-) 6.316.352 lekë, (-) 970.870 lekë, (-)73.823 lekë, (-) 6.778.204 lekë⁴¹; (-) 264.800 lekë dhe (-) 338.918 lekë. Në total, mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve

³⁹ Nga përgjigjet e dhëna në pyetësorë, subjekti ka deklaruar se për vitin 2015, ka shpenzuar për bileta në këtë vit, shumën totale prej 6.000 eurosh dhe, referuar ditëve të udhëtimeve në Australi nga subjekti dhe familja e tij në këtë vit, u përllogaritën 826 ditë qëndrimi për të gjithë familjen [(8 muaj x 30 ditë x 3 persona) + (66 ditë + 15 ditë + 25 ditë)] = 826 ditë. Për rrjedhojë, u përllogarit shuma 4.130 euro si shpenzime qëndrimi (826 ditë x 5 euro/ditë = 4.130 euro), dhe në total shpenzime udhëtimit për këtë vit, rezultoi shuma 10.130 euro (6.000 euro shpenzime biletash + 4.130 euro shpenzime qëndrimi = 10.130 euro) të konvertuara në shumën 1.394.395 lekë me kursin e përdorur nga Komisioni për këtë vit (1 euro = 137,65 lekë). Kjo shumë përputhet me shumën e shpenzimeve të udhëtimit të përllogaritura më sipër nga Komisioni (me një diferencë 1.377 lekë më tepër).

⁴⁰ Përllogaritjet e shpenzimeve jetike në këtë vit, nga Komisioni, në rezultatet e hetimit, rezultojnë të përllogaritura në shumën 448.552 lekë, pasi bashkëshortja dhe fëmijët kanë qenë në Australi dhe janë kthyer në datën 23.08.2015. Sipas të dhënave të INSTAT-it për këtë vit, përllogariten shpenzime jetike në shumën 448.552 lekë [(224.276 lekë shpenzime jetike për subjektin e rivlerësimit + (672.828 lekë ÷ 12 muaj) x 4 muaj për 3 persona = 448.552 lekë].

⁴¹ Nga kontrolli i analizës financiare të kryer për vitin 2014, rezultoi se vlera e apartamentit të kompleksi “{***}”, është përllogaritur në mënyrë të gabuar nga Komisioni në shumën 61.000 euro, konvertuar në shumën 8.546.710 lekë pasi, sipas kontratës së porosisë, referohet se është paguar shuma prej 50.000 eurosh me nënshkrimin e kontratës dhe, referuar mandatit bankar të Raiffeisen Bank, rezultoi të jetë paguar shuma prej 11.002 eurosh nga L. H. në datën 03.06.2021. Për rrjedhojë, në analizën financiare të vitit 2014, në Kolegj, u përllogarit vlera e paguar prej 50.000 eurosh në këtë vit, konvertuar në shumën 7.005.500 lekë, sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

në periudhën e rivlerësimit 2005-2016, është në shumën (-) 14.742.863 lekë, situatë e cila e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

D. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

160. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim vlerësimin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar me vërtetësi deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, në kundërshtim me parashikimet e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

161. Komisioni e ka bazuar vlerësimin e mësipërm në konstatimet se:

- *Subjekti sërish nuk qartësoi mënyrën e fitimit të shtetësisë australiane dhe gjithashtu nuk depozitoi kopje të pasaportës së tij as gjatë hetimit dhe as në prapësime, dokument i cili do të qartësonte situatën mbi gjeneralitetet e subjektit në pasaportat e përdorura. Refuzimi i subjektit për të paraqitur pasaportën australiane, konsiderohet mungesë bashkëpunimi në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, duke krijuar bindjen e Komisionit se ai ka pasur për qëllim të shmangë verifikimin e të dhënave të këtij dokumenti për të arritur një rezultat në favor të tij.*

- *Lidhur me konstatimin mbi ekzistencën dhe përdorimin e dokumenteve të identifikimit me gjeneralitete të ndryshme nga ato të konfirmuara nga Zyra e Gjendjes Civile, në prapësime, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës. Shpjegimet e tij ishin të paqarta dhe jobindëse mbi mundësinë e hedhjes gabim të të dhënave nga oficerët e policisë, të cilat nuk u konsideruan bindëse nga ana e Komisionit pasi, nga hetimi, rezultoi i provuar përdorimi i këtyre dokumenteve në mënyrë të përsëritur, në periudha e vite të ndryshme. Këto fakte eliminojnë mundësitë e ndonjë gabimi material të kryer nga oficerët në pikat e kontrollit.*

162. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës, është tërësisht i pabazuar dhe ka dalë jashtë kornizës kushtetuese dhe ligjore dhe qëllimit të ligjit për kontrollin e figurës. Sipas tij, deklaratat për kontrollin e figurës është plotësuar me vërtetësi nga ana e tij, duke pasqyruar të dhënat identifikuese sipas Zyrës së Gjendjes Civile dhe po ashtu ka plotësuar me vërtetësi numrin e pasaportës australiane, të cilën e dispononte në atë periudhë, si dhe numrin e kartës së identitetit shqiptare, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin ligjor. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka argumentuar se:

(i) Mënyra e fitimit të shtetësisë nuk është objekt i kontrollit të figurës sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 34 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016 dhe se ai ka shpjeguar bindshëm mënyrën e fitimit të shtetësisë, si dhe veprimet e kryera prej tij për fitimin e shtetësisë australiane.

(ii) Nuk ka pasur asnjëherë qëllim që të mos e dorëzojë pasaportën australiane por, për shkak të problemeve familjare që përkuan me ditët e fundit kur duhet të dorëzonte përgjigjet e pyetësorit, ku ndër të tjera ishte kërkuar edhe kopje e pasaportës në fjalë, nuk ka mundur ta gjejë atë dhe, për këtë shkak, ka nxjerrë pasaportën shqiptare, pasi aplikimi për pasaportë australiane kërkon kohë, duke marrë në konsideratë faktin se shteti australian nuk ka zyrë përfaqësimi në Shqipëri.

(iii) Konstatimi i Komisionit në lidhje me përdorimin e pasaportës kanadeze, është tërësisht i gabuar pasi ai asnjëherë nuk ka disponuar pasaportë kanadeze. Pasqyrimi i kësaj pasaporte në të dhënat e sistemit TIMS si pasaportë kanadeze, ka ardhur si rrjedhojë e regjistrimit të gabuar të të dhënave të kësaj pasaporte nga punonjësit e policisë kufitare.

(iv) Konstatimet e Komisionit, për përdorim nga ana e tij të dokumenteve të identifikimit me gjeneralitete të ndryshme nga ato të konfirmuara nga zyra e gjendjes civile, janë tërësisht të pabazuara dhe denigruese për figurën e një prokurori, pasi ai nuk ka qenë asnjëherë person në kërkim apo me rrezikshmëri të lartë shoqërore në mënyrë që të përdorte dokumente të ndryshme identifikimi.

(v) Konkluzioni i Komisionit, bazuar vetëm në të dhënat e sistemit TIMS, është i gabuar pasi dihet që këto të dhëna nuk janë 100% të sakta, pasi ato janë hedhur për shumë kohë në mënyrë manuale dhe, për më tepër, që në vitin 2022 janë bërë objekt i një sulmi kibernetik. Sipas subjektit, nga verifikimi i hyrje-daljeve sipas të dhënave në sistemin TIMS, rezulton se ai ka dalë nga territori i shqiptar me pasaportë kanadeze më datë 10.12.2009 dhe ka hyrë përsëri në 02.03.2011, pra afërsisht dy vite më vonë, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe, ka ushtruar funksionin e prokurorit, çka vërteton se të dhënat në lidhje me këtë pasaportë, e cila pasqyrohet si e lëshuar nga autoritetet kanadeze, janë regjistruar gabim.

163. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues fillimisht konstaton se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar me vërtetësi deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter, duket të jetë bazuar në mosdeklarimin e faktit se në pasaportat e përdorura prej tij, ai ka pasur gjeneralitete të ndryshme nga ato të konfirmuara nga zyra e gjendjes civile. Këtë mosdeklarim, Komisioni e ka vlerësuar si deklaram të pavërtetë në deklaratën e kontrollit të figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, duke e kualifikuar përfundimisht si deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e të njëjtit ligj.
164. Komisioni ka evidentuar në vendim se, nga verifikimi i të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka rezultuar se për shtetasin Sabri H. Kastrati, i datëlindjes 25.09.1971 (datëlindja sipas të dhënave nga Zyra e Gjendjes Civile), nuk ka regjistrime për hyrje-dalje në territorin shqiptar, ndërkohë përgjatë periudhës 01.05.2004 - 27.07.2021, rezulton të jenë regjistruar hyrje-dalje në territorin shqiptar për shtetasin Sabri H. Kastrati, i datëlindjes 17.09.1971. Konkretisht, me dokumentin {***}, janë regjistruar disa hyrje nga data 02.03.2011 deri më 21.10.2020, si dhe disa dalje nga data 21.09.2011 deri më 19.10.2020. Ndërkohë që, nga data 05.11.2004 deri më 19.10.2009, janë evidentuar disa hyrje-dalje për këtë shtetas me dokumentin {***}. Në materialin e përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, evidentohen disa hyrje-dalje të shtetasit Sabri Kastrati, datëlindja 17.09.1971, me dokumentin {***}, me automjetin me targë {***}.
165. Referuar raportit të gjeneruar nga sistemi TIMS, Komisioni ka konstatuar se, me emrin Sabri Kastrati rezultojnë 4 shtetas me datëlindje të ndryshme: (i) Sabri Kastrati, me datëlindje 25.09.1971, me nr. personal {***}, atësia H., mëmësia L., e pashoqëruar me fotografi; (ii) Sabri Kastrati, me datëlindje 15.09.1971, vendlindja Kosovë, nacionaliteti Australi, dokument nr. {***}, shoqëruar me fotografi; (iii) Sabri Kastrati, me datëlindje 17.09.1971, nacionaliteti Australi, shoqëruar me fotografi; (iv) Sabri Kastrati, me datëlindje 28.08.1971, vendlindja Kosovë, nacionaliteti Shqipëri (pa fotografi).

166. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e dërguara më datë 22.07.2024 në Komision, subjekti ka sqaruar se: [...] *Ashtu siç kam deklaruar edhe më parë, përveç nënshtetësisë shqiptare, kam edhe nënshtetësi australiane me të dhënat që janë paraqitur nga ana ime në deklaratën e kontrollit të figurës. Për sa u përket të dhënave të ndryshme dhe pasaportave të ndryshme, të cilat ekzistojnë nën emrin “Sabri Kastrati”, për të cilat ju kërkoni shpjegime, dua të theksoj se unë s’kam asnjë dijeni se nga janë gjeneruar ato të dhëna, pasi ato të dhëna dhe pasaporta nuk janë as përdorur dhe as deklaruar ndonjëherë nga ana ime, përpara ndonjë autoriteti qoftë shqiptar apo i huaj. Aq më tepër që ekziston edhe një pasaportë kanadeze në emrin “Sabri Kastrati” kur unë s’kam qenë asnjëherë në Kanada. Po ashtu, dua të theksoj se unë kam udhëtuar gjithmonë me pasaportën australiane, me të dhënat e deklaruara nga ana ime dhe në asnjë pikë të kontrollit kufitar qoftë në Shqipëri apo të shteteve të tjera ku kam udhëtuar, nuk jam bërë asnjëherë objekt verifikimi për shkak se këto të dhëna ishin të ndryshme. Përfundimisht, dua të nënvizoj edhe një herë faktin se përveç pasaportës australiane, me të dhënat e deklaruara nga ana ime, nuk kam përdorur asnjë pasaportë tjetër, aq më tepër pasaportë kanadeze, për faktin e thjeshtë se ato nuk disponohen prej personit tim dhe, rrjedhimisht, nuk janë përdorur prej meje.*
167. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar përdorimin e pasaportës me nr. {***} për periudhën 2011 deri 2021, e deklaruar nga subjekti në deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe të një pasaporte me numër {***}, përdorur për udhëtime nga viti 2004 deri në vitin 2009, pasaporta të cilat figurojnë në emër të Sabri H. Kastrati, i datëlindjes 17.09.1971, datëlindje e ndryshme nga ajo sipas të dhënave nga Zyra e Gjendjes Civile. Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet se: *Ka pasaktësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës, pasi subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e pasaportës kanadeze. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës, gjeneralitetet e ndryshme nga ato të Gjendjes Civile, të përdorura nëpër dokumente identifikimi të ndryshme. Ngrihen dyshime për deklarime të rreme nga ana e subjektit, pasi gjatë hetimit subjekti ka deklaruar shpenzime për udhëtimet e kryera me pasaportë kanadeze, ndërsa në pyetësonin e dërguar së fundmi, mohon të ketë dijeni lidhur me këtë pasaportë. Është i paqartë nxjerrja dhe përdorimi i këtyre dokumenteve me gjeneralitete të ndryshme nga ana e subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, pasi nuk ka qartësuar mënyrën e fitimit të shtetësisë australiane, duke u mjaftuar vetëm me termin natyralizim, term i cili bazohet në kritere të përcaktuara. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka prapësuar me të njëjtat argumente sikurse edhe në ankim.*
168. Në analizë të kuadrit ligjor lidhur me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës sipas shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, më datë 27.01.2017, ka plotësuar dhe depozituar deklaratën për kontrollin e figurës ku ka deklaruar të dhënat identifikuese të cilat përputhen me të dhënat sipas dokumentit kartë identiteti bashkëlidhur kësaj deklarate.
169. Po ashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka dyshtetësi, shoqëruar me shpjegimin se nga viti 2001, ka fituar shtetësinë australiane, si dhe rezulton që në rubrikën “Pasaporta dhe karta identiteti”, subjekti ka deklaruar: *Pasaportë {***}, data e lëshimit 22.02.2011, vlefshmëria deri më 22.02.2021, vendi i lëshimit/institucioni lëshues: Australia. Kartë identiteti {***}, data e lëshimit 03.03.2009, vlefshmëria 02.03.2019, vendi i lëshimit,*

institucioni lëshues: MB. Bashkëlidhur kësaj deklarate, ndodhet kopje e kartës së identitetit me numër {***}, sipas së cilës vërtetohen të dhënat e deklaruara

170. Në raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Sabri H. Kastrati, DSIK-ja ka konstatuar se formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë e në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe se subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete. Deklarata për kontrollin e figurës nuk përcakton detyrimin e subjektit për të bashkëlidhur kopje të dokumenteve të identifikimit. Referuar sa më sipër, trupi gjykues nuk konstaton pasaktësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës nga ana e subjektit të rivlerësimit.
171. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dalë jashtë qëllimit kushtetues e ligjor për vlerësimin e këtij kriteri, pasi mënyra e fitimit të shtetësisë nuk është objekt i kontrollit të figurës, trupi gjykues vlerëson se, në mënyrë të shprehur, pika 4 e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, i referohet detyrimit për plotësimin e deklaratës së detajuar për figurën dhe deklarimit me saktësi dhe në përputhje me rubrikat përkatëse të saj, të çdo informacioni, të kërkuar. Po ashtu, verifikimi i vërtetësisë së deklaramëve të subjektit të rivlerësimit, është një ndër elementet e përcaktuara në objektin e kontrollit të figurës, sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016.
172. Hetimi i Komisionit në drejtim të mënyrës së fitimit të shtetësisë, duket se në thelb i referohet një situatë paqartësie që ka të bëjë me rubrikën e të dhënave identifikuese të subjektit të rivlerësimit, për shkak të dyshimeve të ngritura gjatë hetimit administrativ mbi përdorimin nga ana e tij të dy dokumenteve të identifikimit, njëri prej të cilëve deklarohet nga subjekti si pasaportë australiane dhe që, sipas të dhënave që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ, duket se përmban gjeneralitete të ndryshme nga ato të deklaruara prej subjektit (sipas të dhënave nga Zyra e Gjendjes Civile).
173. Sa më sipër, në vlerësimin e trupit gjykues, të dhënat e përftuara gjatë hetimit administrativ, justifikojnë hetimin e kryer në drejtim të mënyrës së fitimit të shtetësisë, hetim i cili ka pasur qëllim vlerësimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën për kontrollin e figurës dhe subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të treguar transparencë të plotë mbi paqartësitë e konstatuara në lidhje me të dhënat e tij identifikuese.
174. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në një qasje jobashkëpunuese nuk ka depozituar kopje të pasaportës australiane as gjatë hetimit administrativ dhe as në prapësime ndaj rezultateve të hetimit. Shpjegimet e subjektit se në fakt e kishte humbur këtë pasaportë ditën e dorëzimit të përgjigjeve të pyetësorit dhe se, që prej asaj dite, nuk e disponon më atë, nuk janë bindëse. Për më tepër, referuar të dhënave sipas shkresës nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit⁴², konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në muajin qershor 2021, ka udhëtuar me një tjetër pasaportë australiane, e cila mban numrin {***}⁴³. Në këto kushte, edhe në rast se subjekti i rivlerësimit mund të mos e dispononte më fizikisht pasaportën e deklaruar prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës (e cila kishte vlefshmëri nga 22.02.2011 deri më 22.02.2021), ai që nga viti 2021 duket se ka qenë i pajisur me një tjetër pasaportë australiane,

⁴² Shkresa nr. {***} prot., datë 29.07.2021.

⁴³ Sipas të dhënave në raportin e hyrje-daljeve në territorin shqiptar, për Sabri H. Kastrati, i datëlindjes 17.09.1971, për periudhën 01.05.2004 deri 27.07.2021, ka rezultuar dalje më datë 27.06.2021, ora 10:00, me autoveturën me targë {***}, nga pika kufitare Morinë.

të cilën duhet ta kishte depozituar pranë Komisionit, në funksion të qartësimit të dyshimeve të ngritura në lidhje me përdorimin e të dhënave të ndryshme.

175. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka qenë i besueshëm në deklaratimet e tij sa i takon pasaportës australiane, si dhe ka dëshmuar mungesë vullneti për t'iu përgjigjur kërkesave të Komisionit në lidhje me pasaportën e tij. Trupi gjykues vlerëson gjithashtu se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin kushtetues dhe ligjor që të deklaronte faktet dhe të jepte të gjitha shpjegimet që çmonte të domosdoshme për të provuar vërtetësinë e deklaratimeve të tij, si dhe çdo specifikë tjetër të rastit, me qëllim mundësimin e kryerjes së një vlerësimi objektiv dhe të plotë lidhur me saktësinë e plotësimit të deklaratës për kontrollin e figurës.
176. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se: *refuzimi i subjektit për të paraqitur pasaportën australiane, konsiderohet mungesë bashkëpunimi në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, duke krijuar bindjen e Komisionit se ai ka pasur për qëllim të shmangë verifikimin e të dhënave të këtij dokumenti për të arritur një rezultat në favor të tij, por nuk gjeti të bazuar në prova dhe në ligj konkluzionin tjetër të Komisionit se: subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar me vërtetësi deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, në kundërshtim me parashikimet e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

E. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

177. Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, Komisioni ka konstatuar në vendim disa problematika në lidhje me tri çështje penale, analizuar të “Gjetjet e tjera lidhur me kriterin profesional”, të cilat janë marrë në shqyrtim bazuar në informacionet e dhëna nga autoritetet verifikuese. Pavarësisht këtyre konstatimeve, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni arriti në konkluzionin se: *sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 [...], subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se, pavarësisht problematikave të konstatuara, për një vlerësim tërësor të këtij kriteri, subjekti ka arritur nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.*
178. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur pretendime në ankim në drejtim të konstatimeve të Komisionit lidhur me këtë kriter. Sa më sipër, për problematikat e evidentuara nga Komisioni⁴⁴ në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale, të cilat nuk kanë qenë objekt ankimi nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se konkluzionet e Komisionit mbeten të pandryshuara. Megjithatë, në kushtet kur problematikat e tjera që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e kontrollit të figurës konstatohen të jenë të paidentifikuara në arsyetimin e vendimit të Komisionit, si bazë për arritjen e konkluzionit se ato së bashku me problematikat që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale cenojnë besimin e publikut, rezultojnë se ato (problematikat për profesionalin) mbeten të vetmet të identifikueshme në këtë kontekst. Për pasojë, ato u vlerësuan të pamjaftueshme për t’u konsideruar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te

⁴⁴ Konkretisht, procedimi penal nr. {***/2011, trajtuar në paragrafin 59.3; procedimi penal nr. {***/2016, trajtuar në paragrafin 59.4; si dhe procedimi penal nr. {***/2021, trajtuar në paragrafin 59.5 të vendimit objekt shqyrtimi.

sistemi i drejtësisë, në atë nivel që të mund të justifikohet dhënia e masës disiplinore sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

179. Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit, bazuar në konkluzionet e arsyetuara më sipër në këtë vendim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 800, datë 19.09.2024, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 800, datë 19.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Sabri Kastrati.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 17.12.2025.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi